



PO KATEDRALES!



**KUR UNË VË SHAMINË,
S'E BËJ KURRSESI PËR TË
TREGUAR SE JAM MË E MIRË!**



**DO T'I EDUKOJMË FËMIJËT
TANË, ASHTU SI NA MËSON
FEJA E JONË!**

Viti XV - Nr. 8 (174),
Gusht, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Aksaja, njësia e pakuptueshme

e majtes së pulsit...



DETYRAT KOLEKTIVE DHE ATO INDIVIDUALE

(Farzi ajn dhe farzi kifaje)

ME FARZ AJN kemi parasysh atë detyrë që kërkohet prej çdo njeriu dhe për të cilën do të pyetet, ndërsa farz kifaje është detyrë kolektive, por nëse një njeri prej këtij kolektivi e kryen këtë detyrë, atëherë përcjellja shkarkohet nga të tjerët dhe nuk kërkohet prej tyre për ta kryer!

Nga ky kontekst, myslimanët e dinë mbi bazën e këtij përkufizimi se, po ta kryejnë disa atë detyrë, të tjerët nuk kanë përcjellje. Nëpër qjuhët e njerëzve nuk qarkullon, përveçse një shembull i vetëm i kësaj detyre e, ajo është namazi i xhenazes!...



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Nëse nisim e kompleksohemi sa herë taborrat e Iblisit grricen ndaj besimtarëve që edukojnë e mësojnë fëmijët e tyre me namaz e, vajzat me mbulesën e përkushtimit dhe devotshmërisë, atëherë më mirë të rruajmë mjekrat!

Do t'i edukojmë fëmijët tanë me moral e namaz, me hixhab e fé, me dashuri për atdheun dhe tokën tonë, me pastërtinë dhe sinjeritetin në komunikim, me dashurinë për dijen, leximin dhe shkencën, me dëshirën për të bërë mirë dhe edukatën në marrëdhënie me më të diturin e më të rriturin, si dhe mëshirën ndaj më të voglit!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë dhe t'i mësojmë se, gjëja më e shtrenjtë në jetë është besimi në All-llah, në Kur'an dhe në Hz. Muhammedin (a.s), prej ku burojnë edhe krejt të mirat e kësaj bote dhe të Ahiretit!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë të jenë të kujdesshëm ndaj haramëve në jetë; ndaj alkoolit, si nana e krejt pështirësive, ndaj imoralitetit, ndaj injorancës, ndaj fanatizmit të verbër, ndaj thirrjeve shterpë dhe propagandave të djallëzuara që i duan fëmijët tanë pa besim e fé, pa Islam e

DO T'I EDUKOJMË FËMIJËT TANË, ASHTU SI NA MËSON FEJA E JONË!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë se, Hz. Muhammedi (a.s), është i Dërguari i fundit i All-llahut në tokë, i fundit i një zinxhiri të mrekullueshëm të dërguarish, që mësuat dhe edukuan krejt popujt e botës të adhurojnë e të duan Një Zot të Vetëm e të Pashoq!

Kur'an, pa moralin e hallallit, pa drojen e Zotit; të tillët janë fatkeqësi për veten, familjen, kombin!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë se të duash për vëllanë tënd atë që do për vete, është prej përsosmërisë së besimit dhe se kopracia është prej shejtanit të mallkuar!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë të thonë me mburrje: "Unë jam musliman!", duke pasur respekt për veten dhe duke kthyer mbrapsht këdo që fut hundët në të drejtën legjitime të përzgjedhjes fetare dhe praktikimit të saj, kudo qofshim!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë se kushdo që ndryshon prej nesh, duhet respektuar, brenda logjikës së kufijve të të drejtave, jo përtej tyre, sepse pranimi i tjetrit përtej asaj që i takon, është abuzim me të drejtën vetanake, urë drejt shkatërrimit!

Do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë me namazin, me përluljen para Zotit, me agjërimin e Ramazanit, si shtyllë esenciale në përsosmërinë e durimit dhe vlerave, me dhënien e zekatit dhe sadekasë, si forma më e virtytshme e dëshmimit të bamirësisë, altruizmit dhe shpirtmadhësisë në jetë, me haxhin, si dëshmia më e plotë e unitetit global të muslimanëve, si një ymet i vetëm, për të cilin duhet të punojmë me sa të kemi forcë e pasuri!

Mbi të gjitha, do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë se, kjo gjithësi nuk është krijuar vetvetiu; Zoti i saj dhe i yni, është All-llahu; i Vetëm, i Pashoq,

që s'ka as djallë, as vajzë, që është i Përhershëm pa fillim, i Përhershëm pa mbarim, që çdo gjë i është krijuar, që kur do diçka e urdhëron: "Bëhu!" dhe ajo bëhet, që çdo gjë e secili prej nesh është krijuar me një kader të paracaktuar, për të cilin, Ai është i Plotëdijshëm, i Pakrahasueshëm me asgjë dhe askë!

Sikurse, do të vazhdojmë të edukojmë fëmijët tanë se, Hz. Muhammedi (a.s), është i Dërguari i fundit i All-llahut në tokë, i fundit i një zinxhiri

**DO TË VAZHDOJMË
TË EDUKOJMË FËMIJËT TANË
DHE T'I MËSOJMË SE, GJËJA
MË E SHTRENTË NË JETË
ËSHTË BESIMI NË ALL-LLAH,
NË KUR'AN DHE NË
HZ. MUHAMMEDIN (A.S),
PREJ KU BUROJNË EDHE KREJT
TË MIRAT E KËSAJ BOTE
DHE TË AHIRETIT!**

të mrekullueshëm të dërguarish, që mësuat dhe edukuan krejt popujt e botës të adhurojnë e të duan Një Zot të Vetëm e të Pashoq!

All-llahu ju dashtë e ju pastë në mbrojtje, ju dhashtë mbarësi e bekim në rrugëtimin tuaj të paqte në edukimin e fëmijëve!

Shkodër, më 22 korrik 2017

AKSAJA, NJËSIA E PAKUPTUESHME E MATJES SË PULSIT...



Kam përshtypjen se sikur, (mos qoftë e thënë), të ishte dhunuar ndonjë kishë e sinagogë, siç shohim me dhembje dhe zemërim të thellë atë që po ndodh me Aksanë Sherife, bota demokratike do ngrihej në këmbë në alarm botëror!

Hipokrizia në trajtimin e Aksasë dhe Palestinës martire, dëshmon se kjo botë dhe ky sistem, kanë nevojë urgjente për shërim, që buron nga Krijuesi i botëve dhe Fjala e Tij e padeforuar!

Përderisa në atë tokë të shenjtë, burrëshat muslimane lindin çdo ditë djem e vajza krenarë për fenë, tokën dhe historinë e tyre, nuk do ketë ushtri tmerri që e ndalon dot pastrimin e asaj toke të dhunuar e të zaptuar padrejtësisht!

Sot, bota islame përjeton momente paradoksale në përpjekjet për Rizgjim dhe Rimëkëmbje. Muslimanë në mbarë botën përpëliten në krahët e sistemeve politike në orientim afetar, fetarëve me indoktrinim laik, xhemateve që propagandojnë mosafrimin me politikën, myftilerë që reagojnë me komandë politike, drejtues fetarë të katapultuar me qëllim moçalizimin e mëtejshëm të organizimeve të muslimanëve, të tjerë, fanatikë e të izomuar nga ana në kulmin e ekstremitetit në marrëdhënie me të krishterë e jomuslimanë të tjerë, mendjengushtë në leximin e teksteve, a mospërfillës ndaj tyre, thirrës drejt një mode të re iluminizmi, që minon në themel

trashëgiminë shekullore të zhvillimeve diturore në botën tonë, por jo vetëm!

Përtej kësaj, ka dekada që ka nisur procesi i rizgjimit nëpërmjet kontributit të burrave të urtë, që sot nuk janë më, porse ajo çfarë mbollën me durim e përkushtim, ka nisur të japë frutet e duhura gjithandej, anembanë botës...

Aksaja, u dhunua sërish!

Bota perëndimore heshti, si zakonisht në kësi rastesh!? Ajo islame, u revoltua sërish me lutje e solidarizime...!? Por, deri kur? Deri kur, gjithsecili prej nesh të çlirohet nga dozat relative të hipokrizisë në marrëdhënie me fenë, politikën, "të mëdhenjtë", zullumet e qeverive, injorancën dhe meskitinitetin në marrëdhëniet brenda bashkësisë sonë... Deri kur të mbushemi me kurajo legjitime për të mos pranuar më kësi realitetesh meskine, me të cilat është rrethuar edhe e sotmja e jonë...


Teksa po përfundoj këto shënime, më vjen ndër mend zhurma e ambientalistëve për Xhaminë e Madhe në Tiranë, ajo që improvizohet për Xhaminë e Madhe në Prishtinë, krakëllimat e disave për plazhiste me hixhab, e të ngjashme!

(Ne e kemi Aksanë në mes nesh, por s'e ndjejmë, a bëjmë se s'na intereson...!?)

Aksaja, njësia e pakuptueshme e matjes së pulsit në mes nesh...


Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, 22 korrik 2017



*"Që në orët e para,
Islami vërtetoi se
është feja
e krejt racave,
teksa përgafoi
Selman Farisiun
(pers),
Bilal Habeshiun
(etiopian) dhe
Suhejb Rumiun
(romak), duke
i shkrirë në një
realitet të vetëm!"*

XHORXH BERNARD SHOW



Shejkh Muhamed El-Gazali

DETYRAT KOLEKTIVE DHE ATO INDIVIDUALE

(Farzi ajn dhe farzi kifaje)

poshtë flamuri i tyre.

Detyrat kolektive kërkojnë nga shteti dy gjëra, të cilat burojnë që të dyja nga përgjegjësitë e tij.

Gjëja e para: Bindja e plotë se këto detyra kanë gjetur numrin e mjaftueshëm të specialistëve për t'i bërë ballë detyrave. P.sh në qoftë se populli ka nevojë për 100 mjekë dhe nuk gjenden veçse 50 të tillë, shteti duhet të interesohet për plotësimin e numrit të mjaftueshëm, i cili siguron shëndetin e përgjithshëm dhe nuk lejohet aspak që të neglizhojë në këtë detyrë.

Gjëja e dyta: Të ndjekë me mjetet e tij mënyrën e kryerjes dhe seriozitetin e punës, në mënyrë që interesi i përgjithshëm të jetë në baza të shëndosha..

Populli, i cili është i paaftë të shfrytëzojë begatitë e Zotit (xh.sh) në tokë, nuk do të mund të kryejë ashtu siç duhet mesazhin e Tij. Populli, i cili është i pafuqishëm të mobilizojë dhuntitë e myslimanëve, me duart e tij hedh veten në shkatërrim.

Le të pyesim se, sa uzina armësh duhen ndërtuar për të ndihmuar të pafuqishmit? Sa specialistë duhen përgatitur për t'ia arritur këtij qëllimi?

Ndoshta detyra individuale mund të përfshijë shtyllat e adhurimeve, si: Namazin, zeqatin etj, shtyllat e moralit si: sinqeritetin, turpin.

Ndoshta mund të përfshijë largimin nga mëkatet e mëdha dhe, të gjitha këto në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me ndërgjegjen e personit dhe

me karakterin e tij të veçantë.

Ndërsa detyra kolektive ka të bëjë me ruajtësit e rendit, gjykatat, postet e ndryshme zyrtare, ngritja dhe zhvillimi i arteve dhe i arkitekturës që shërbejnë në ndërtimin e pallateve dhe, të tjera si këto.

Bashkësia njerëzore është një bashkësi me interesa të ndërthura. Njerëzit, të gjithë kanë nevojë për njëri-tjetrin. Aparati drejtues, kulturor, shëndetësor, ekonomik dhe ushtarak, në qenien e shoqërisë i përngjan aparatit nervor, tretës, atij të frymëmarrjes e të qarkullimit të gjakut në trupin e njeriut. Nga këtu kuptojmë se, detyrat individuale dhe detyrat kolektive ndërthuren në jetën e përgjithshme plotësisht me njëra-tjetrën.

Le ta sqarojmë më tepër çështjen. Namazi është detyrë individuale, sepse çdo mysliman mund ta kryejë këtë detyrë, prandaj askush nuk është i përjashtuar prej saj. Ndërsa drejtësia, mësimdhënia, inxhinieria janë detyra kolektive, sepse jo çdokush është i aftë për të qenë gjykatës, mësues apo inxhinier.

D.m.th, në qoftë se ndonjë kandidat për gjykatës me kualifikimin përkatës caktohet nga shteti në këtë post të përshtatshëm për të, atëherë kryerja e detyrave që kërkon ky post kthehet në detyrë individuale, sikur namazi dhe agjërimi dhe, në asnjë mënyrë nuk i lejohet që të neglizhojë, apo të shpërdorojë detyrën, sepse çdo nënvleftësim apo abuzim konsiderohet

INJORANCA E MYSLIMANËVE PËR OBLIGIMET KOLEKTIVE, NATYRËN DHE NDIKIMIN E TYRE, ËSHTË SKANDALOZE. KJO NDODHË, SEPSE TEK DISA "FETARË", KA DALLIM MES FORMAVE TË ADHURIMEVE TË OBLIGUARA DHE KRYERJEN E PUNËVE CIVILE TË NDRYSHME. E PARA, ADHURIMI I OBLIGUAR, TEK ATA KONSIDEROHET FE, NDËRSA E DYTA NUK ËSHTË ADHURIM, VEÇSE RASTËSISHT.

mëkat ndaj Zotit e, nuk i pranohet justifikimi se ky abuzim ka ndodhur sepse ajo është detyrë kolektive.

Sakrifica e njeriut dhe përpjekja e tij duhet të ndahen në mënyrën më të drejtë mes namazit që është detyrë individuale për të dhe, kryerjes më përpikëri të detyrës së gjykatësit që i është ngarkuar, në mënyrë që, drejtësia të mbulojë gjithë shoqërinë dhe të çojë të gjitha të drejtat në vendin e tyre. Ndoshta, mësimi i çështjeve të drejtësisë zgjat dhjetë fish më tepër se, sa koha për mësimin e namazit! Po le të jetë më tepër se, siç është namazi adhuring edhe drejtësia është adhuring.

Ajo që thamë për drejtësinë thuhet edhe për mësimdhënien, mjekësinë dhe për çdo profesion për të cilin ka nevojë shoqëria. Shoqëritë njerëzore, në të pesë kontinentet, e kuptojnë këtë realitet të vërtetë dhe krijojnë mijëra e mijëra vende pune e profesione të ndryshme. Ndihmojnë me mijëra njerëz dhe shpenzojnë shuma të mëdha nga buxhetet e tyre që t'i sigurojnë këto interesa. Të gjitha vendet e punës pa përjashtim janë amanete përgjegjësi dhe realizimi i tyre është një e drejtë që duhet zbatuar.

Por ndër myslimanët, ku është për të ardhur keq, ka njerëz dhe drejtues të atillë, të cilët renditën në vendin e parë për humbjen e amaneteve, të premtimeve, ndërsa punët zyrtare janë të kërcënuara. Posti, apo vendi i punës, në shumicën e rasteve është më tepër burim për të marrë se, sa mjet për të dhënë!

Injoranca e myslimanëve për obligimet kolektive, natyrën dhe ndikimin e tyre, është skandaloze. Kjo ndodhë, sepse tek disa "fetarë", ka dallim mes formave të adhurimeve të

obliguara dhe kryerjen e punëve civile të ndryshme. E para, adhuringi i obliguar, tek ata konsiderohet fe, ndërsa e dyta nuk është adhuring, veçse rastësisht.

Kam parë disa prej tyre ndenjor nëpër zyra me një paraqitje të lodhur, ku njerëzit i vijnë për nevojat e tyre dhe, ata i mbarojnë punë kur të donë, e neglizhojnë sa të donë. Dhe kur afrohet koha e namazit të drekës, fillojnë të përgatiten përpara kohe.

Njërit prej tyre i thashë: "Ajo që po lë pa bërë nuk është me më pak rëndësi se sa ajo që do të bësh.. Shkathtësia jote në kryerjen e nevojave të njerëzve në një kohë sa më të shkurtër e në formën fetare më të mirë është vaxhib⁴, si namazi e agjërimi".

Më tha: "Ne po përgatitemi për namazin që është obligim dhe, punën tonë do ta bëjmë pasi të kryejmë të drejtën e Zotit!"

I thashë: "Bukur, të jesh i kujdesshëm ndaj namazit që është obligim në kohën e tij, por s'do të thotë patjetër ta kryesh atë në fillim të kohës apo në mesin e saj! Do të ishte më mirë për ty t'i mbaroje punë këtij njeriu, i cili ka ardhur nga një vend i largët, i shqetësuar për nevojat që ka, pa harruar se namazi edukon njeriun të jetë i ndjeshëm me përgjegjësinë për detyrën. Namazi nuk zgjat më tepër se disa minuta".

Ne, kështu nuk e nënvleftësojmë vlerën e namazit që është obligim dhe faljen e tij brenda kohës, por ne mundemi të vëmë rregull në kryerjen e tij me xhemat në fillim të kohës dhe, të tjerët ta kryejnë p.sh pas mbarimit të orës së mësimi në shkollë, në fabrikë pas mbarimit të turnit, në spital kirurgët dhe infermierët pasi të kenë kryer planifikimet e tyre, duke i caktuar për këtë gjë një kohë të drejtë, në mënyrë që të mos e shfrytëzojnë rastin njerëzit përtacë.

Të konsiderosh punë e ndryshme publike e shoqërore gjë pa vlerë, punë kote, ose diçka që lejohet neglizhenca, mungesa e seriozitetit apo, do ta bëj kur të kem kohë, e gjitha kjo quhet humbje e një obligimi dhe, humbja e tij është e ndaluar⁵!

(Nga libri: "Probleme në rrugën e jetës islame", përkthyer nga arabishtja: Lavdrim Hamja)

4. Obligim.
5. Haram.



"Islami është feja

që e ka të mundur

përballjen me ateizmin

dhe valët e shpërbërjes,

prej së cilave

lëngojnë shoqëritë

e industrializuara sot.

Islami do të tërheqë

shumë prej

të diplomuarve

të universiteteve,


sidomos ata që janë

lodhur dhe rënduar nga

debatet teologjike!"

- Aktorja italiane,
Marcella Michelangeli,
e kthyer në Islam.

1. Farzet.
2. Detyrë individuale.
3. Detyrë kolektive.





Klodiana Smajlaj, sociologe

Teksa po flisja me një mikeshën time mbi temën e përfolur kohëve të fundit në rrjetet sociale, atë të mbulesës së grave muslimane, më preku pa masë komenti në të cilin thuhej:

“Ju të mbuluarat luani me kartën morale, sikur të kishit ekskluzivitetin e moralit dhe ndershmërisë, ndërkohë që rroba nuk të bën të tillë nëse nuk je. Ju i imponoheni botës me arrogancën se posedoni të vërtetën absolute.”

Nuk ia kam idenë se kush mund t'i ketë thënë këto fjalë, por kuptohet qartë se është deformuar imazhi mbi vajzat me mbulesë. Në vijim dua t'i rrëfej asaj e çdokujt tjetër që mendon ngjashëm me të, me fjalë zemre e përjetim shpirti atë që unë ndjej.

E kam vënë shaminë fiks para 16 vjetësh. Asokohe një vajzë e re, studente, nuk mund ta dija se një copë pëlhere mbi kokë do të ndillte aq shumë reagime, përçmime, provokime e agresivitet verbal ndaj mbajtëses së saj. Unë bëra zgjedhjen time, e cila nuk kishte pse t'i bënte njerëzit përreth të reagonin në forma nga më të çuditshmet.

Nëse ndonjëra nga mikeshat e mia shihnte si liri minifundin, unë shihja si të tillë shaminë. Ishte moshë kur unë nuk e kuptoja se ç'nënkuptonte dekani i asaj kohe kur na thoshte ne të mbuluarave: “Vetëm ecja juaj në korridoret e Fakultetit, është propagandë më vetel!” Me naivitetin e atëhershëm, mendoja me vete: “Ç'kanë vallë me mua?! Unë as flas për fe e as jam shqetësuar për kënd.” Me të vërtetë që s'flisja. Kujtoj se isha një studente e mirë, me ato ambiciet e mia në jetë, por që kisha këtë aksesori shtesë, që më bënte të ndjehesha si e huaj në ato ambiente të cilave u përkisja.

KUR UNË VË SHAMINË, S'E BËJ KURRSESI PËR TË TREGUAR SE JAM MË E MIRË!

Se ç'mbartte me vete copa e pëlhurës që kisha vënë mbi kokë, se ç'pengesa do të më sillte në vazhdimësi, nisa ta kuptoja vetëm kur si e sapodiplomuar, me një mesatare të mirë, njëri nga pedagogët m'u shpreh me një ton të keqardhur se nëse s'do të kisha qenë me shami, do të kisha pasur shumë shanse që në një të ardhme të bëhesha pjesë e stafit mësimdhënës. Aty kuptova se ajo copë pëlhere s'ishte thjesht një copë, por ishte shndërruar në etalon të vlerësimit tim si qenie.

Vitet kaluan dhe unë ndonëse kisha një profilizim social e gjuhë të huaja në zotërim, – elementë me të cilët mund të gjeja punë në shumë vende të favorshme, në organizma kombëtarë e ndërkombëtarë, – isha e detyruar, që pikërisht për shkak të shamisë, të punoja sa në një shoqatë në tjetrën, të gjitha ato me profil fetar. Mos më thoni se nuk e kam provuar tjetërkund! E kam provuar, e kam riprovuar, por kam gjetur fytyra e reagime aspak mikpritëse. Për pasojë, m'u prenë krahët e fillova ta bind veten se do të isha më e qetë e më e patrazuar në besimin tim larg atyre ambienteve, ku më së paku vëreja picërrim sysh e vërenjtje fytyre, sa herë që u dilja përpara.

I tillë ishte realiteti para shumë vitesh. Sot nuk është më i tillë. Sot shoh se ka shumë njerëz që e pranojnë të ndryshmen, që e duan të bukurën, që e vlerësojnë zgjuarsinë, edhe kur ajo vjen nga një kokë e mbuluar. Për këtë lumturohem. Lumturohem për aftësinë që kanë fituar përgjatë viteve bashkëkombësit e mi për ta dashur e për ta pranuar tjetrin. Lumturohem për vajzat e reja që janë më të lira e më të pa paragjykuara për të bërë zgjedhjet e tyre sesa ç'ishim ne dikur.

Kur unë vë shaminë, s'e bëj kurrsezi për të treguar se jam më e mirë, më e ndershme e më pa vese sesa ti. Shamia ime nuk ka lidhje me ty. Shamia ime, në thelb, pavarësisht vlerave sociale që mbart, ka lidhje me Zotin.

Vënia e shamisë ngjan me një akt dashurie që njeriu bën për të shtrenjtin e zemrës. Këtë akt e bën jo nga frika, jo për t'u dukur, por nga dashuria e madhe që ke për të. Kur e kryen atë veprim,

nuk të intereson se mund të bëhesh qesharake në sytë e të tjerëve, nuk të intereson nëse të tjerët të thonë: “Sa e marrë është kjo!” Nuk të intereson asgjë. Të intereson vetëm vetja, i shtrenjti yt dhe marrëdhënia që ti ke me të. E tillë është edhe vënia e shamisë për mua. Është një veprim dashurie që unë bëj për të Shtrenjtin tim, që në këtë rast nuk është krijesë, por Krijues.

Kur unë e pata vënë shaminë atëherë, nuk më interesonte asgjë që më thonin të tjerët. Asnjë përqeshje, asnjë veprim, asgjë. Njësoj e ndjej edhe sot. Njësoj e besoj edhe sot. E besoj se Zoti më ka zbritur një urdhër dhe unë e ndjej se duhet të vazhdoj ta zbatoj. Fakti që unë e besoj këtë si të vërtetë, s'është as krim, as mendjengushtësi, as privim i lirisë. Të kishte qenë i tillë, unë tashmë pas 16 vjetësh, do të isha tunduar të zbulohesha. Po, po, besomë që s'do ta kisha më këtë copë pëlhere, sepse nga jeta kam marrë shumë goditje, pikërisht për shkak të saj. E nëse s'do të kishte qenë dashuria që vlon thellë brenda meje për Zotin tim, unë do të kisha hequr dorë tashmë, do të isha lodhur, do të isha dorëzuar.

Pra, ta rithem sërish nga zemra. Nuk jam një engjëll në trajtë njeriu që ecën rrugëve. Jo, jam një mëkatore si ti, një njeri që orvatet çdo ditë të mbijetojë në dallgët e jetës. Jam një njeri që bën betejë të përditshme me veten e në fund të ditës kontrollojnë zemrën se sa i është ndotur. Besomë, përpiqem në vazhdimësi të përmirësohem, dhe këtë s'e bëj për të të treguar se jam më superiore sesa ti. E bëj për t'u afruar më shumë me Zotin. Është po Ai Zot që më mëson të të dua ty, të të respektoj e të mos të të gjykoj për zgjedhjet e tua.

Nëse copa e pëlhurës që mbaj mbi kokë do të shihej po aq e natyrshme sa ç'shihet çdo prurje e modës në veshje, ndoshta ne të dyja do ta pranim njëra-tjetrën natyrshëm.

Unë nuk kërkoj asgjë nga askush, asgjë përtej asaj që kam dhënë e që jap çdo ditë. E vetmja gjë që dua është që ne si qenie të gjalla me ndërgjegje, të mbuluara apo të pambuluara, të mos e humbasim dëlirësinë me të cilën kemi lindur.

HISTORIA E RRALLË E ROJTARIT TË FUNDIT OSMAN TË XHAMISË AL-AKSA

Kjo është historia e ushtarit osman i cili i mbeti besnik detyrës së tij për 57 vjet në xhaminë Al-Aksa, pas tërheqjes së ushtrisë osmane nga Jeruzalemi më 9 dhjetor 1917.

Historiani Ilhan Bardakçi u takua me të më 12 maj 1972 dhe vendosi të shkruante për këtë takim të jashtëzakonshëm: Xhamia Al-Aksa. E premte, 21 maj 1972.

Miku im, gazetari Said Terzioğlu dhe unë po shëtisnim nëpër vendet e shenjta me ndihmën e udhërrëfyesit tonë. Ishte pikërisht në majë të shkallëve në oborrin e dytë të xhamisë së shenjtë, ku e pashë atë. Ishte gati dy metra i gjatë. Kishte disa rroba të vjetra në trupin e tij të moshuar, por ende qëndronte guximshëm dhe drejtë. Shikova fytyrën e tij dhe u frikësova. Dukej si dikush që kishte përmbysur një tokë të tërë shterpe, dhe kishte shumë shenja në fytyrë.

“Kush është ky njeri?”, pyeta udhëzuesin tim. Ai i ngriti shpatullat dhe u përgjigj: “Nuk e di ... duhet të jetë dikush i çmendur. Ai ka qëndruar gjatë gjithë kohës këtu, nuk kërkon kurrë asgjë nga askush.”

Nuk e di pse, por iu afrova atij dhe ... “Sigurisht, çfarë është ajo?”, thashë.

i thashë në turqisht “Selamu Aleykum baba (babë).” Sytë e tij u hapën me shkëlqim dhe në turqisht ai u përgjigj “Alejkum Selam ogul (bir)!” U trondita. Kapa duart e tij dhe i putha ... “Kush jeni ju?”, pyeta. Ai shpjegoi ... “Unë jam Tetari Hasan nga trupa e 20-të, Batalioni i 36-të, ekipi i Skuadronit të armatimit të rëndë, i cili u vendos në xhaminë Al-Aksa ditën kur humbëm Kudsën...”

USHTARËT OSMANË TË VENDOSUR NË XHAMINË AL AKSA

Qeveria osmane kishte lënë pas vete 401 vjet, 3 muaj dhe 6 ditë sundimi të Kudsit. Ishte e diel, më 9 dhjetor 1917 kur ata duhej të evakuoeshin nga Palestina. Shteti ishte në prag të shpërbërjes dhe vetëm një skuadron u la në xhaminë Al-Aksa për ta mbrojtur atë nga grabitjet, para se ushtarët britanikë të merrnin qytetin.

Zot i Madh! ... E shikova edhe një herë: koka e tij, si një ballkon i minaresë mbi shpatullat e tij të tendosura, një flamur i puthshëm. Kapa duart e tij edhe një herë dhe ai filloi të flasë:

“A mund të kërkoj një të mirë prej teje, biri im? Unë kam një amanet që e kam mbajtur fshehtë prej vitesh, a do ta dorëzosh këtë amanet për mua?”

“Kur të ktheheni në vend, nëse arrini ndonjëherë në Tokat Sanxhak, shkoni dhe gjeni komandantin tim që më ka dërguar këtu, Kapitenin Musa. Puthjani duart për mua dhe tregoni atij ... Tetari Hasan i skuadronit të 11-të të armatimit të rëndë nga provinca Igdir mbetet ende në postin në të cilin e kenë lënë.”

Zemra ime pothuajse ndaloi së rrhuri!

Vite më vonë, shefi i ushtrisë vendosi të thërrasë Ilhan Bardakçi-në për ta ndihmuar në gjetjen e këtij ushtari të lavdishëm, kur mësoi për këtë rast në televizionin e qeverisë turke. Atë kohë Bardakçi do të shkruante:

“Tetari Hasan ishte njëri prej nesh ... fati i tij për pak po harrohej. Kjo është pikërisht ajo çfarë ndodhi. Ne as që e kërkuam atë, e lerë më ta gjenim. Ai ishte i paarritshëm. Ai ishte si një pemë e lavdishme selviqe që po përpiqej të arrinte qiellin. Dhe ne, edhe sikur të kishim ngritur kokat tona lart, do të dukeshim sikur një bari i hollë i cili mezi arrinte deri te rrënjët e tij. Si tjerët, edhe ne harrojmë, ashtu kishim harruar edhe atë diamant i cili mbeti në postin e tij ... Tetarin Hasan”.

(www.tesheshi.com)



Dr. Ardian Muhaj, *historian*

Koncepti i një kryeobjekti fetar që shërben si qendër për objektet e tjera fetare të një feje mund të shtrihet pa frikë edhe në rastin e fesë islame. Ngjashëm me fetë e tjera, edhe në fenë islame organizimi dhe strukturimi i organizimit lipset ta ketë një kryeqendër. Në rastin e xhamisë së madhe të Prishtinës, për të cilën sot po diskutohet fatkeqësisht akoma projekti, nuk bëhet fjalë për një xhami të madhe, por për një xhami qendrore. Për këtë arsye pretendimi se kemi tashmë boll xhamia, është i pavlerë sepse sado xhami të kesh, duhet medoemos të ekzistojë edhe një xhami qendrore, drejtuese apo kryexhami.

Madje pikërisht fakti se ka shumë xhamia në Kosovë, e bën të domosdoshëm dhe urgjent nevojën e lidhjes dhe bashkërendimit të këtyre xhamive me një xhami drejtuese, me një xhami mesazhi i së cilës në raport me xhamitë e tjera është si ai i një mësuesi në raport me nxënësit e vet. Mësuesi flet ex-cathedra, pra nga tavolina qendrore, dhe nxënësit qëndrojnë në raport me mësuesin siç do të duhej të qëndronin xhamitë e tjera me xhaminë qendrore. Një rrjet xhamish që nuk e ka një kryexhami që të udhëzojë e japë direktivat më të mira, është si një klasë pa mësues që flet e kumton nga katedra. Një klasë e tillë pa mësues, natyrisht që do të ishte e zhurmshme, e parregullt dhe madje shqetësuese për klasat e tjera me mësues.

Kjo është arsyeja që kryexhamia shërben si burim autoriteti mbi dhe ndaj, xhamive të tjera. Kryexhamia është mjet efikas kundër radikalizmit fetar, sepse në vend që të rinjtë apo vizitorët që vijnë apo qëndrojnë në kryeqytet, të kryejnë detyrimet e tyre fetare nëpër xhami lagjesh e sokaqesh,

PO KATEDRALES!

duke rënë pre e rrymave radikale, do të mund të ndiheshin plotësisht të qetë në një kryexhami, të njohur nga shteti e shoqëria si e tillë, me një pozicionim të lehtë për t'u gjetur dhe për t'u mbërritur dhe me një infrastrukturë të plotë rituale. Në fakt, deri sot, duke i diskriminuar myslimanët, duke ua mohuar të drejtën e një kryexhamie, shteti dhe pushteti i ka ndihmuar radikalizmit dhe radikalëve që kanë nisur të shquhen nëpër Kosovë. Duke e lënë komunitetin e myslimanëve pa një zë qendror, vetëm kemi kontribuar në dallshimin e çorientimin e njerëzve. Një prind do të ishte shumë më i qetë nëse do ta dinte se fëmija i tij frekuenton kryexhaminë që njihet e dihet nga të gjithë, se sa xhamitë e shumta të rrugicave e mëhallëve, ku nuk dihet se

hap kutinë e Pandorës për rrymimet e reja radikale për të zënë rrënjë në rrënjët e shkulura të traditës shekullore.

Fakti që feja ortodokse dhe ajo katolike i kanë tashmë faltoret e tyre katedrale apo qendrore, dhe ajo myslimane jo vetëm që nuk e ka, por edhe tash sa vite pas ndërtimit të katedrales ortodokse dhe asaj katolike, po ridiskutohet projekti i saj, është një dëshmi e rrëshqitjes së shoqërisë sonë në kurthin e oportunitizmit të ekstremizmit dhe diskriminimit fetar. Askush më mirë se shqiptarët në përgjithësi dhe shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë në veçanti nuk e kanë më të qartë se çfarë do të thotë që shumica e popullsisë të diskriminohet. Është e pafalshme që një popull që e ka vuajtur më shumë se askush



kush mëson e predikon.

Të njëjtën derë hapur për radikalizim e lë edhe projekti i mbështetur nga civilsat shoqërorë. Myslmanët i kanë njohur iriqët, gaforret e hardhucat përpara se këto t'i stilizonte arkitekturalisht Zaha Hadid, dhe nuk ka arsye t'u thuhet se një projekt në formë gaforreje apo iriqi është më modern se sa një projekt i përdorur për shekuj të tërë. Ka plot vende në Prishtinë ku mund të aplikohen iriqlleqet e hardhucclleqet arkitektonike. Shmangja nga tradita arkitekturore, nuk bën asgjë tjetër veçse nxit çorientimin dhe radikalizimin e besimtarëve, veçanërisht të rinjve. Hedhja poshtë e traditës arkitektonike,

diskriminimin nga një pakicë njerëzish të lidhur me pushtetin, të pranojë që kjo të ndodhë sërish pa reaguar. Çdo ditë që kalon duke ua mohuar shumicës myslimane të drejtën e pasjes së një kryexhamie, një xhamie qendrore apo xhamie katedrale, është një ditë e zezë në historinë e diskriminimit shoqëror.

Përfaqësuesit e çfarëdo shoqate kanë të drejtën e tyre të qëndrojnë në hije apo indiferent ndaj diskriminimit të një grupi të caktuar të shoqërisë, por asnjëherë nuk mund të bëhen promovues të diskriminimit social. Përfaqësuesit e një shoqërie civile që në vend që të reagojnë për diskriminimin shumëvjeçar të myslimanëve, kërkojnë

që ky diskriminim të vazhdojë edhe më shumë, nuk mund të jenë përfaqësues të një shoqërie civile të një shteti të shekullit XXI, por vetëm përfaqësues të ndonjë vëllazërie ideologjike të shekujve të mesjetës së hershme. Një shoqëri e tillë civile më mirë mos qoftë!

Rasti i diskriminimit të myslimanëve duke mos ua lejuar një kryexhami, apo duke gjetur lloj-lloj pretekstesh për t'ua vonuar gëzimin e një të drejte që të tjerët tashmë e kanë, na sjell te një shembull tejet i dëmshëm dhe me pasoja shumë të rënda e afatgjata për mirëkuptimin e marrëveshjen shoqërore. Ky shembull, për fat të keq tregon se radikalizimi fetar e ka tejkaluar sferën e individit apo të grupit të ngushtë informal, dhe është bërë politikë e pushtetit qendror apo lokal komunal.

Radikalizimi i institucioneve shtetërore apo të qeverisjes lokale, vendosja e tyre me kohë të plotë në llogoren e diskriminimit social ndaj një bashkësie të caktuar, është një kampanë alarmi se shoqëria po shkërmoqet dhe gërryhet së brendshmi.

Një shoqëri, përfaqësuesit e së cilës shfrytëzojnë pushtetin për t'ia nënshtuar shoqërinë synimeve e ndjeshmërive të momentit, që shfrytëzon çdo mundësi për agjenda revanshiste, nëse shteti dhe pushteti vihen në shërbim të një eksperimenti social, ajo shoqëri është e rrezikuar të dështojë në tërësinë e vet. Përfaqësuesit e shtetit dhe të pushtetit nuk zgjidhen për të ndryshuar popullin e tyre, por për ta përfaqësuar atë.

Xhami katedrale apo kryexhami kanë të gjitha kryeqytetet europiane. Fakti se të tilla kryexhami kanë Lisbona, Madridi, Londra, Parisi, Berlina, Brukseli, e madje edhe vetë Roma, e hedh poshtë çdo pretendim se civilsave shoqërorë u intereson Europa e orientimi evropian. Të mendosh se kryexhami madhështore të tilla kanë dekada që qëndrojnë në zemër të këtyre kryeqyteteve europiane, ku myslimanët nuk përbëjnë as 10 për qind të popullsisë, dhe se u dashka të ndalohej, pengohet apo vonohet në Prishtinë, ku myslimanët përbëjnë 90 për qind të saj, është shënues që të sqaron se civilistat për Europë e mendojnë Athinën e Beogradin, si dy kryeqytete ku bashkësitë shekullore myslimane nuk kanë të drejtë të kenë xhaminë e tyre katedrale. Nëse për Europë nënkuptohet Athina, i vetmi kryeqytet në BE pa një xhami apo



Beogradi ku digjen e shkatërrohen xhamitë, hallall e paçi dhe e meritofshi atë "europë"!

Ajo që ia vlen të theksohet është se pikërisht ky radikalizim shoqëri-civilist e institucional i shqiptarëve, nuk ka asnjë lidhje me frymën europiane të të drejtave të njeriut dhe me klimën e mirëkuptimit e harmonisë fetare që më së fundi pas shumë shekujsh po mbizotëron edhe në Europë. Harmoninë dhe mirëkuptimin fetar shqiptarët e kanë të dëshmuar historikisht që në shekullin XI, kur megjithëse bota e krishterë u nda në dy pjesë që nuk u ngjiten më kurrë, në katolikë e ortodoksë, shqiptarët qëndruan një e bashkë edhe kur e gjithë bota u nda e u përça.

Kësisoj vijmë te paradoksi, që megjithëse shqiptarët janë popull i denjë për shekullin e njëzet e dytë, mbi kokë u është imponuar një klasë politike e intelektuale, që nuk e ka tejkaluar akoma as shekullin e njëmbëdhjetë. As në shekujt XVI-XVII kur në Europë bënte kërdrinë inkuizicioni dhe luftërat e përgjakshme fetare mes të krishterëve, dhe kur në trojet shqiptare sundonin osmanët, nuk dëshmohej një ekstremizëm i tillë fetar, siç po ushqehet një ekstremizëm i tillë sot. Bartësit e këtij ekstremizmi fetar, gjysmë intelektualë flasin në emër të vlerave europiane duke e justifikuar diskriminimin fetar të bashkatdhetarëve të tyre me thirrjen në orientimin perëndimor, evropian e më the e të thashë.

Të tillë gjoja intelektualë që rropaten dyerve të ambasadave europiane për një vizë shengen, nuk janë as në lartësinë e thonit të dinjitarëve shqiptarë të shekujve të kaluar, të cilët edhe pse kishin kapur majat e pushtetit qendror e vendor osman, asnjëherë

nuk dëshmohen të kenë kërkuar nga bashkatdhetarët e tyre të marrin këtë apo atë fe, se kështu do t'i bëhej qejfi pushtetit osman, edhe pse ata jetonin në një shtet teokratik dhe këta jetojnë sot në një shtet që supozohet të jetë laik.

Një shembull që ia vlen të përmendet dhe mbase mund t'u vlejë edhe Kryetarit të Kosovës e Kryetarit të Prishtinës dhe që shpresojmë se do t'i ndërgjegjësojë që në vend të pingpongut me taksapaguesit e tyre, një ditë të premtë në kohën e xhumasë të dalin për t'u solidarizuar me bashkatdhetarët e tyre myslimanë që falen rrugëve plot baltë e gropa, si në verë si në acar, ashtu siç kanë dalë për t'u solidarizuar edhe me kauza të tjera. Le të marrin si shembull Ahmet Pashë Dukagjinin, pinjollin e derës së Dukagjinëve, i cili mbas një karriere të suksesshme megjithëse u bë kryeministër i shtetit më të fuqishëm të kohës (1512-1515), u kujdes që Zadrime, ose fusha mes Shkodrës e Lezhës që kish qenë pronë e Dukagjinëve dhe të cilat shteti osman ia kishte njohur si të tijat, të lërë amanet dhe të kërkojë nga Sulltani garanci se brez pas brezi, përgjithmonë do të njiheshin si vakëf dhe asnjë pashë apo sundimtar lokal nuk do të ndërhynte në punët e brendshme të bashkësisë zadrimore, dhe ata do të qeveriseshin nga krerët e tyre fetarë e lokalë.

Një mysliman i mirë, një politikan i suksesshëm, një ushtarak i përsosur, një nga njerëzit më të rëndësishëm të botës në atë kohë, mbron lirinë e plotë fetare të bashkatdhetarëve të tij. Njerëz të tillë, janë shembull se si mund të jesh yll shqiptari edhe pse shpend i lirë i botës, dhe se si mund të jesh më përparimtar sesa politikanët tanë të vegjël me emra të mëdhenj shekuj më pas.

“EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËR I PËRKTHYER NGA **H. VEHBİ S. GAVOÇI** - SHKODËR 1996)

PROFETI MUHAMMED (A.S) BABA

Në moshën 25 vjeçare u martua me zonjën Hatixhe. Siç kemi folur edhe më parë, i fali Zoti (xh.sh) katër vajza rresht: Rukijen, Zejnepen, Ummu Kulthumen dhe Fatimen. Më vonë i lindën edhe dy djem. Të gjithë fëmijët i vdiqën, sa qe gjallë Profeti (a.s), përveç Fatimes e cila vdiq gjashtë muaj pas tij.

Arabët, kur u lindnin vajza, nuk i donin. Madje disa prej tyre hapnin një gropë, i futnin vajzat brenda dhe i varrosnin për së gjalli. Të mjerët ata, për turpin që kanë bërë! Kush e di, ndoshta vajza u gjendet prindërve të vet në pleqëri, kurse djemtë të marrë me jetën e vet harrojnë nënë e babë!

Profeti (a.s) nuk u dëshpërua aspak me të katër vajzat që i lindën rresht. Ai e dinte se ata janë rrisht i Zotit (xh.sh).

U rritën vajzat me edukatën e nënës bujare dhe me interesimin e babait shembullor.

Kur u rritën vajzat, filluan kërkesat për martesë. U martua më e madhja me Ebul-Asin, djalin e Rabiut, i cili pëlqeu vonë fenë islame dhe vdiq në Medine mbas Luftës së Bedrit.

Rukija me motrën e saj Ummu Kulthumen u martuan me djemtë e Ebu-Lehebit. Utbe mori të parën dhe të dytën vëllai i tij, Utejbë.

Fatimja ishte e vogël, prandaj edhe u martua më vonë, kur emigruan në Medine.

Në moshën 40 vjeçare u përgëzua ai Zotëri si Profet. Hatixhja, bashkëshortja e Muhammedit, qe e para grua që pranoi fenë islame, së bashku me vajzat e saj, kurse ndër burra qe Ebu Bekri e ndër të rinjtë Aliu (r.a).

Dhe siç dihet, njerëzit pak nga pak pranuan fenë islame duke lënë pas shpine besimet e trashëguara, adhurimin e përuljen ndaj idhujve që, duke qenë të sajuar prej guri apo druri nuk gjykojnë, nuk shohin as dëgjojnë.

Disa të tjerë u vonuan, iu duk e vështirë të ndryshojnë fenë, të ndryshojnë zakonet e sjelljet e këqija, të linin fitimet që kishin dhe rangun shoqëror që gëzonin në fenë e vet. E kështu disa filluan ta shqetësojnë Profetin (a.s), t'i sillnin ngatërresa e ta dëmtonin.

Njëri prej armiqve të fesë islame e të mësimëve të Profetit (a.s) tha që Muhammedi (a.s) është rehat, vajzat i ka të martuara, prandaj duhet të arrijmë që t'ia kthejmë vajzat në shtëpi, të jetojnë larg e të ndara nga burrat, në mënyrë që të mërzitët Profeti (a.s).

Gruaja e Ebu Lehebit, nëna e dy djemve, Utbe e Utejbë i thirri bijtë e vet e u tha: “Unë nuk mund të jetoj në shtëpi me ju, derisa ju të mos ndani vajzat e Muhammedit.”

Ata të mjerë, që vdiqën të pafe, si babai e nëna e tyre, ndanë gratë e ndershme dhe i përzunë nga shtëpitë e tyre.

Pas pak kohe që kthyen vajzat në gjini, Hz. Osmani bujar e nga familje e ndershme, erdhi e kërkoi vajzën e Profetit (a.s), Rukijen dhe u martua me të. Në këtë kohë muslimanët ndiqeshin e keqtrajtoheshin, prandaj Hz. Osmani i kërkoi leje Profetit (a.s) të emigronte me gruan e vet e me disa shokë në Abisini.

Në muajin Ramazan të vitit të dytë islam, u zhvillua Lufta e Bedrit. Hz. Osmani nuk doli të luftonte, sepse e kishte zonjën të sëmurë. Kur u kthye Profeti (a.s) nga lufta, Rukija, vajza e Pejgamberit (a.s), gruaja e Osmanit, kishte vdekur.

Profeti (a.s) u prek thellë nga vdekja e vajzës së dashur, por duhej pranuar vullneti i Zotit (xh.sh).

Një ditë Hz. Osmani shkoi për vizitë tek Profeti (a.s). Ai Zotëri duke e parë të dëshpëruar e pyeti: “Çka ke, pse je mërziur?” Hz. Osmani iu përgjigj: “Ej Resulull-llah, më vdiq gruaja e më këputi shpirtin, m'u ndërpre lidhja që kam pasur me ju si dhëndër.”

Profeti (a.s) u përmallua dhe me dashamirësi i tha: “Kam një vajzë tjetër, Ummu Kulthumen, po ta jap për grua. Ju a pranoi?” Që atë ditë Hz. Osmani u njoh si i zoti i dy Dritave.

Kur vdiq edhe ajo në vitin e nëntë të emigrimit, Hz. Osmani u dëshpërua shumë. Profeti (a.s), duke dashur t'i lehtësonte brengën e thellë, i tha se, po të kishte një vajzë të tretë, do t'i ia jepte për grua.

Edhe Ebul Asit, që kishte për grua zonjën Zejnepe, i thanë idhujtarët që ta ndante të shoqen, se në vend të saj do t'i jepnin vajzën më të mirë të Kurejshit. Ai zotëri i nderuar iu përgjigj me bindje

të thellë: “Vallahi, nuk e lë kurrë gruan time e nuk pranoj në vend të saj asnjë vajzë nga Kurejshët.” Dësh Zoti që këtij t'i vijë fundi i mirë.

Në Luftën e Bedrit, në rreshtat e luftëtarëve armiq ishte edhe dhëndri Ebul Asit, i cili si shumë të tjerë u zu rob.

Sipas rregullave, robërit e luftës do të lireshin të lirë me këto kushte: secili rob lufte do të lihej i lirë po të paguante një shumë të caktuar të hollash. Ai rob lufte që nuk kishte të paguante, ishte i detyruar që të mësonte dhjetë fëmijë myslimanë të shkruanin e të lexonin.

Ebul Asit, dhëndri i Profetit (a.s), i dërgoi fjalë gruas së tij, vajzës së Profetit (a.s), Zejnepes, që t'i dërgonte paratë e nevojshme për të shpëtuar nga robëria dhe të kthehej pranë familjes në Mekë. Mirëpo e shoqja, duke mos pasur të holla në shtëpi, i dërgoi bashkëshortit një relik (varse) të çmueshëm, pikërisht një relik që ja pat dhuruar e ëma, Hatixhja e ndershme, me rastin e martesës.

Kur e pa Profeti (a.s), e njohu menjëherë, u pre, ra në mendime dhe u pezmatua shumë. Atëherë ai iu lut sahabeve që ta lënë të lirë dhëndrin, pa ia marrë relikun, por me kusht që ai të dërgonte vajzën e Profetit (a.s) nga Mekja për në Medine. Kjo kërkesë u pranua.

Ebul Asit shkoi në shtëpi të vet, përgatiti gruan për udhëtim e cila u gëzua pa masë, se në shtëpi të babait do të ishte e lirë të ushtronte të gjitha obligimet fetare.

Zejnepja, e shoqëruar nga vëllai i Ebul Asit, u nis për udhë. Rrugës një nga armiqtë e fesë islame, Hubari, u doli para dhe trembi devenë. Zejnepja, që në atë kohë ishte shtatzënë, u rrëzua nga deveja. Nga tronditja fëmija vdiq. Natën, për t'i shpëtuar ndjekjes së armiqve, zonja Zejnepe, mori rrugën për në Medine, që të bashkohej me babain e dashur dhe me motrat.

Kur mësoi Profeti (a.s) se çfarë kishte pësuar vajza e tij e madhe, u hidhërua pa masë dhe urdhëroi që kudo që të gjendej Hubari me shokë të kapej dhe të digjej në zjarr. Të nesërmen ai Zotëri tha: “Dje urdhërova të digjej Hubari me shokë, sot them jo, sepse me zjarr nuk ndëshkon kush, përveç Zotit (xh.sh)”¹

Erdhi vajza e sëmurë tek babai, i cili

1. Sire Ibn Hisham: 2/232.

u gëzua shumë, që e bija shpëtoi dhe mbeti gjallë.

Pas pak kohe në rrugë u kapën disa tregtarë dhe u sollën në Medine. Mes tyre ishte edhe dhëndëri i Profetit, Ebul Asit. Ai shkoi tek e shoqja dhe i tregoi se ç'i kishte ngjarë. Ajo shkoi te Profeti dhe i tha para shokëve se i kishte dhënë besën Ebul Asit. Të gjithë e dëgjuan këtë fjalë, Profeti (a.s) tha: “Edhe më i vogli ndër ne, po të japë besën për të tjerët, besa e tij ruhet.”

Profeti shkoi në shtëpi dhe e porositi Zejnepen që të nisej me të shoqin, ta kishte kujdes, por të mos flinte me të.

Ebul Asit u kthye në Mekë, shiti pasurinë që kishte, ktheu të gjitha borxhet që kishte marrë dhe pranoi fenë islame. Një gjë të tillë s'e kishte bërë më parë, sepse duke patur borxhe, të mos kujtonin të tjerët se po ndërrojnë fenë për të mos paguar borxhet.

Më në fund edhe ai mori rrugën për në Medine, rrugën e dritës, harmonisë dhe të shpëtimit në këtë jetë dhe në jetën e ardhme. U prit mirë nga Profeti (a.s) nga shokët e tij dhe e shoqja. Profeti ia ktheu gruan. Mirëpo ajo mbas një viti u sëmur rëndë dhe vdiq duke lënë një djalë, Abdullahin dhe një vajzë Umamen. Tregohet se vajza i ka pasë ngjarë nënës së vet dhe Profeti (a.s) e ka dashur aq shumë, sa që një herë e mbarti në shpinë, ndërsa po falej.

Fatimja ka qenë vajza e katërt, për të cilën babai i saj, Profeti Muhammed (a.s) ka thënë: “Gratë më të mira në xhenet janë: Hatixhja, mandej Fatimja, mbas saj Mejremja e në fund Asija, gruaja e Faraonit.” Në një hadith tjetër, siç shkruan Buhariu: “Zonja e grave të xhenetit është Fatimja.”

Tregojnë se, kur shkonte Fatimja për të vizituar babain e vet, ai çohet në këmbë, e puthte dhe e ulte në vendin e tij. Edhe ajo, po ashtu bënte me babain e vet.

Zonja Aishe tregon se, kur Profeti ishte i sëmurë, para vdekjes, erdhi Fatimja e cila i ngjante në të ecur babait të vet. Ai Zotëri i tha: “Mirë se vjen, o bijë!” E vuri në krah të djathtë dhe i foli një fjalë në vesh. Ajo qau. Mbas pak i foli në vesh një fjalë tjetër. Ajo qeshi. Zonja Aishe e pyeti Fatimen se ç'ka i kishte thënë herën e parë, kur ajo qau dhe herën e dytë, kur ajo qeshi. Zonja Fatime nuk kallëzoi, duke thënë se ai ishte sekret i babait.

Mbasi vdiq Profeti (a.s), zonja Fatime tregoi se ç'i kishte thënë babai i dashur. “Babai më tha: “Xhebraili këndonte me mua Kur'anin një herë në Ramazan, kurse kësaj here e kënduam dy herë. Kujtoj se më është afruar vdekja”, prandaj qava

“...Allahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të larqojë ndytësinë e mëkateve dhe t'ju pastrojë deri në skaj.” E pastaj tha: “O Zot, këta janë familja ime!”

herën e parë. Pastaj më tha: “Ti do të jesh i pari pjesëtar i familjes që do të vdesë mbas meje. “E për këtë qesha dhe u gëzova.”

Zonja Fatime lindi kur Profeti (a.s) ishte 38 vjeç. Kur ai Zotëri mbushi 43 vjet, u urdhërua të shpallë haptas misionin e vet. Filloi me fisin e vet. Mbasi foli e predikoi, mes tjerash Profeti tha: “Në jetën e ardhme, në ahiret, të gjashtë fëmijët e robit të Menafit nuk i vlejnjë gjë, nëse nuk besojnë. Axhë Abazin e djalin e Muttalibit, nuk e ruan gjë para Zotit, nëse nuk beson. Vajza ime, Fatimja, më kërkon para e të tjera sende sa të dojë, por të gjitha këto nuk i vlejnjë asgjë para Zotit, nëse nuk beson.”

Zonja Fatime ka vuajtur si të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes dhe shokët e tjerë të Profetit (a.s) nga ndjekjet e keqtrajtimet e të pafeve.

Ajo së bashku me babain e nënën e vet, me motrat e saj u nguajua për tri vjet në vendin e quajtur Shiyab Ebu Talib, duke duruar punë të rënda, thatësirën e padurueshme dhe të gjitha vështirësitë e tjera të rrethimit.

Një ditë, kur ishte ai Zotëri te Qabja e madhërueshme, disa të pafe deshën ta mërziun. Sollën plëncin e ngrohtë të një deveje të posa prerë dhe ia vunë në shpinë, ndërsa ai po falej në sexhde. E pau Zonja Fatime atë punë horash, vrapoi shpejt duke sharë të pafetë dhe i ndihmoi babait të vet ta largonte të keqen nga trupit. Sapo u lirua ai Zotëri i tha vajzës së vet: “Ata u munduan të më mundin e të më ligështojnë, por nuk ia arritën, Zoti (xh.sh) më ruan, por ti mbuloje gjoksin.” Ndërsa Zonja Fatime po përpiquej të ndihmonte babain e vet i ishte zbuluar gjoksi. E kjo ishte një pakujdesi e rëndë, prandaj dhe ai Zotëri, i tërhoqi vërejtjen, ndonëse ishte në vështirësi.

Kur u bë Zonja Fatime 18 vjeç, erdhi Ebu Bekri të kërkonte dorën e saj. Profeti (a.s) i dha këtë përgjigje: “Pres

gjykimin e Zotit.” Po ashtu edhe Hz. Ymeri përsëriti po atë kërkesë dhe mori të njëjtën përgjigje. Më vonë erdhi edhe Hz. Aliu, të cilit para Profetit (a.s) iu mor goja nga turpi. E pyeti ai Zotëri: “Çka do, pse ke ardhur? Mos ndoshta ke ardhur të kërkosh Fatimen për grua?” Hz. Aliu me ndrojtje ju përgjigj: “Po”.

Profeti, i urdhëruar nga Zoti (xh.sh), pranoi martesën e vajzës së vet të dashur me Hz. Aliun (r.a).

Natën e martesës Profeti (a.s) kërkoi pak ujë për abdes. Atë ujë ia hodhi Aliut dhe Fatimes dhe bëri dua për to. “O Zot, bekoji këta dhe fëmijët e tyre!”

Hz. Aliu e pyeti si në llastim Profetin (a.s): “O Profet i Zotit, kë do më tepër, mua apo Fatimen?”

Profeti tha: “Fatimja është më e dashur, e ti je më i shtrenjtë.”

Zoti (xh.sh) i fali Fatimes tre djem: Hasanin, Hysejnin dhe Muhsinin dhe dy vajza: Zejnepen dhe Ummu Kulthumen. Profeti (a.s) i donte shumë këta fëmijë që u rritën, sa qe ai zotëri gjallë, i përkëdhelte, luante me ta e shpesh thonte: “Këta janë dy fëmijët e mi, fëmijët e vajzës sime. O Zot, unë i dua dhe Ti duaji, merr në mbrojtjen Tënde këdo që do këta!”

Tregojnë se Profeti (a.s) një ditë mori për dore Hasanin dhe Hysejnin derisa hyri në shtëpi. Aty i uli secilin në një gju, pastaj afroi Fatimen dhe Aliun pranë vetes dhe lexoi versetin: “...Allahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndytësinë e mëkateve dhe t'ju pastrojë deri në skaj.”² E pastaj tha: “O Zot, këta janë familja ime!”

Profeti (a.s) ka qenë baba i dashur. Për këtë bën fjalë tregimi i mëposhtëm.

Një ditë, kur po falej me shokët e vet, u vonua në sexhde. Disa sahabë u frikësuan se mos i ndodhi gjë gjatë faljes. Pas pak ngriti kryet e plotësoi faljen. Lidhur me këtë e pyetën se çfarë kishte patur. Ai Zotëri me thjeshtësi iu përgjigj: “Jo, nuk pata asgjë, asnjë shqetësim, por kur rashë në sexhde, më hipi në shpinë djali. Unë nuk lëviza dhe nuk dëshirova të ngrihem, deri sa djali vetë të ulej nga shpina ime.”

Një shok shkoi për vizitë tek Profeti (a.s), ndërsa ai Zotëri ishte duke luajtur me një nip, e puthte dhe qeshte me të. Miku, si me çudi tha: “Unë kam dhjetë fëmijë e nuk kam puthur asnjërin prej tyre!” Menjëherë iu përgjigj Profeti duke thënë: “Kij mëshirë në zemër, ai që nuk mëshiron tjetrin, nuk mëshirohet!”

2. Kur'ani, EL-Ahzabë: 33.



Gëzim Kopani
Myfti i Pukës

JETA NË MEJTEPE DHE MEDRESE

Imam Sahit Islam Hoxha u lind më 15 maj 1898 në fshatin Lajthize të Pukës. Babai i Sahitit quhej Islam ndërsa nëna Sut. Nga fëmijët e familjes Hoxha, Sahiti ishte fëmija më i shkathët. Në një moshë shumë të re i ndahet nga jeta babai duke i lënë kështu jetim: Sahitin, Bajramin, Fatimen.

Një ditë teksa punonte afer shtëpisë së tij shikon disa bashkëmoshatarë të cilët udhtonin drejt Pukës për të ndjekur studimet në Mejtepin e Xhamisë së Koder Hanit⁽¹⁾. Sipas djalit të tij, Ramadan Hoxha kemi: “Sahiti së bashku me vëllanë e tij Bajramin dhe bashkëmoshatarin e tij, Shaban Rexhen kanë ndjekur Mejtepin e Pukës për rreth 4 vjet.”⁽²⁾ Sipas të dhënave mësimit e para islame, imam Sahit Hoxha, po ashtu edhe imam Shaban Rexha, i morën nga hoxha i njohur, Zenel Hoxha.⁽³⁾ Në këtë kohe Sahiti mund të ketë qenë rreth 12 vjeç⁽⁴⁾. Përveç Sahit Hoxhës, Shaban Rexhës dhe Bajram Hoxhës kishte edhe nxënës të tjerë të cilët ishin shokë me Sahit Hoxhën, si: Zenel Aga dhe Shaban Aga⁽⁵⁾.

Pas Mejtepit të Pukës, Sahit Hoxha së bashku me imam Shaban Rexhen vijuan mësimit në Mejtepin e Xhamisë së Kabashit⁽⁶⁾. Ishte rreth 16 vjeç kur imam Sahit Hoxha vendosë të ndjek mësimit islame në Mejtepin e xhamisë Kabash.

Në librin e autorit Idriz Ahmetaj “Shaban Rexha Ahmeti, Njeriu i Punëve të mira” shkruan: “...Tek po flisnin një ditë me Sahit Islamin (Hoxha) një bashkëmoshatar që ishte pak më i madh, Shabani mësoi së në Kabash ishte hapur Mejtepi.”⁽⁷⁾ Po ashtu këtu përmendet se: “Unë (thotë Shabani) sot jam gati 16 vjeç dhe po mbetem pa shkollë.”⁽⁸⁾ Në fakt familjarët e Sahitit, por edhe të Shabanit e kishin të vështirë lejen

JETA E IMAMIT, SAHIT HOXHA (1898 - 1976)

për të ndjekur mësimit në Mejtepin e Kabashit, pasi ata, duke e ditur se fshati Lajthiz me fshatin Kabash ishin shumë larg nga njeri-tjetri dhe për më tepër duhesh kaluar lumi i Gomines, i cili ishte shumë i rrezikshëm gjatë dimrit. Pavarësisht kësaj, Sahit Hoxha vendosi të vazhdojë studimet në Mejtepin e Kabashit⁽⁹⁾. Sipas të dhënave, Sahiti së bashku me bashkëmoshatarin e tij, Shabanin u regjistruan në Mejtepin e Kabashit rreth vitit 1916.⁽¹⁰⁾ Në këtë mejtep, Sahiti ndoqi mësimit për rreth 4 vjet për të vazhduar më pas studimet në Medresenë e Shkodrës.⁽¹¹⁾ Sipas një të dhëne tjetër, kemi se: “Sahit Hoxha ka ndjekur për 3 vite mësimit islame në Mejtepin e Kabashit.”⁽¹²⁾ Si rezultat i varfërisë së madhe që kishte familja e Sahitit, ai pothuajse rrezikoi ndërprerjen e studimeve në Medresenë e Shkodrës. Sipas prof. Xhemal Meçit, kemi se: “Ishte interesimi i imam Sadik Prishtinës që Sahit Hoxha të vazhdonte Medresenë e Shkodrës.”⁽¹³⁾.

Sipas djalit të Sahitit, Ramadan Hoxha, ishte mirësia e Zotit që Sahiti të takohej me një njeri shumë të mirë i quajtur Man Tepelia⁽¹⁴⁾. “Dëshira për ta vazhduar (Medresenë) ishte aq e madhe, sa që filloi të shkonte në mësim pa ngrënë. Duke ecur, i bie të fiket prej urie. Kalimtarët e ndihmojnë të ngrihet. Tregtari bamirës, Man Tepelia i siguron bursën.”⁽¹⁵⁾ Me ndihmën tetë vjeçare të Man Tepelisë, imam Sahit Hoxha përfundoi me sukses Medresenë e Shkodrës.⁽¹⁶⁾

JETA NË SHKODËR DHE NË PUKË

Sahiti, pasi përfundoi me sukses Medresenë e Shkodrës, u emërua imam në xhaminë e Drishtit⁽¹⁷⁾. Gjatë qëndrimit si imam në këtë xhami, imam Sahit Hoxha u njoh edhe me Hafiz Sabri Koçin⁽¹⁸⁾. Sipas të dhënave, aty ai shërben si imam për rreth dy vjet.⁽¹⁹⁾ Nga viti 1936 deri në vitin 1937, Sahit Hoxha shërbeu si imam në xhaminë Mes-Myselim.

Rreth vitit 1938, Sahit Hoxha shërbeu si imam në xhaminë e fshatit Micoj.⁽²²⁾ Pas fshatit Micoj, imam Sahit Hoxha kalon në xhaminë e fshatit Vaspas të Kukësit ku shërben nga viti 1939 deri në vitin 1940⁽²³⁾. Familjarët e imam Sahit Hoxhës tregojnë se ai ka shërbyer si

imam edhe në xhaminë e fshatit Kabash të Pukës, edhe në vende të tjera, por kjo me kohë më të shkurtër si për shembull, gjatë muajit Ramazan.⁽²⁴⁾

Ndërsa sipas prof. Xhemal Meçit, kemi: “Sahit Hoxha ka shërbyer në fshatin Kabash për rreth 26 vjet nga viti 1941 - 1967.”⁽²⁵⁾ Gjatë kësaj kohe imam Sahit Hoxha ka qenë edhe anëtar i Këshillit të Myftinisë Pukë. Ai ka shërbyer si imam përkrah imam Elez Hoxhës⁽²⁶⁾, Qazim Nushit, Shaban



IMAMI, SAHIT HOXHA

Rexhës dhe Beqir Laçit. Kishte raste që këta imam bashkoheshin dhe këndonin Mevlude, dua, salavate, sidomos në muajin e Ramazanit. Këtë, imam Sahiti e ka bërë kryesisht në fshatrat si: Lajthiz, Kabash dhe Meçe.

Sipas të dhënave në fshatin Lajthiz, Sahit Hoxha së bashku me Shaban Rexhen kanë kryer shërbime fetare në disa shtëpi. Ramadan Hoxha thotë: “Babai im kryente shërbime në disa shtëpi të fshatit tim. Kishte raste që babai im shkonte bashke me imam Shaban Rexhen.” Po ashtu djali i tij, Ramadan Hoxha tregon: “Për të kryer shërbime fetare, Sahiti shkonte në shumë shtëpi të fshatit Kabash. Kujtoj që shtëpitë myslimane të Kabashit kishin dreken dhe darkën e caktuar në respekt të Hoxhës.” Të njëjtën gjë kemi edhe në fshatin Meçe, ku ai qëndronte tek miq, të cilët ishin; Furrikajt⁽²⁷⁾ si fisi Kopani⁽²⁸⁾. Përveç shtëpisë së Ahmet Isen Kopanit, ai ka qëndruar duke kënduar Kur'an, salavate edhe Mevlud edhe tek shtëpia e Jemin

Kopanit.”⁽²⁹⁾ Niman Avdis, dhe tek shtëpia e Jah Met Krovës⁽³⁰⁾ dhe Zyber Llukës⁽³¹⁾.

PËRBALLJA E IMAM SAHIT HOXHËS ME SISTEMIN KOMUNIST

Gjatë jetës së tij, imam Sahit Hoxha mbahet mend për njeri punëtor, atdhetar dhe që ishte çdo herë në shërbim të njerëzve për besim dhe liri. Këtu mund të përmendin faktin së gjatë LANÇ⁽³²⁾ shtëpia e tij ka qenë bazë e strehimit të ushtarëve partizanë. Sipas Ramadan Hoxhës, kemi: “Në shtëpinë tonë janë strehuar ushtarët partizanë, si: Nuri Allazani, Shefqet Peçi, Ali Bytyçi etj.”⁽³³⁾ Sipas djalit të tij, Ramadan Hoxha, në vitin 1951 Komuniteti Mysliman i Shqipërisë e ka dërguar si të deleguar në Këshillin e quajtur si “Këshilli i Gjanë”.

Imam Sahit Hoxha duke shikuar përplasjet që filloi të krijohet sistemi komunist, sidomos gjatë viteve 1960-1963 vendosë të mos përfshihet më në lëvizjet politike të asaj kohe madje filloj të dalë kundër. Arsyeja ishte feja. Në vitin 1966 sistemi komunist vendos të heq fenë. Kësaj furtune anti fetare nuk i shpëtoi as imam Sahit Hoxha. Me urdhër të Sekretarit të Parë të Partisë në Pukë u vendos të kontrollohet shtëpia e imam Sahit Hoxhës. “Mbaj mend, ishte natë e Bajramit të madh. Shtëpia rrethohet nga forcat e policisë, pasi bëjnë një kontroll, efektivat nuk arritën të gjejnë asnjë gjë komplementuese, përveç librave islamë, që babai studiointe. Në këtë natë babain e arrestojnë dhe e marrin me vete duke e burgosur. Në fakt ky veprim u bë me qëllim që të nesërmen të mos falej namazi i Bajramit të Madh.

Vijuan hetimet për tre ditë, por më kot, pasi nuk arritën të gjejnë gjë dhe kështu ditën e tretë e liruan babain me kusht, që të mos dalë më në rrugë me uniformën e klerikut islam, si: çallma, xhybja etj.”⁽³⁴⁾

Me ndalimin e fesë, imam Sahit Hoxha u vetmua duke e përjetuar keq ndalimin e besimit në Zot nga sistemi komunist, i cili tashmë kishte mbyllur të gjitha xhamitë e rrethit Pukë.

Në moshën 78 vjeçare, saktësisht më, 16 tetor 1976, imam Sahit Hoxha i dorëzon shpirtin Krijuesit të gjithësisë, duke lënë pas kontributin e tij në ngritjen e fesë islame në rrethin e Pukës.

Në vitin 2016, Myftinia Pukë përkujtoi 25 Vjetorin e Riorganizimit të

Myftinisë Pukë, me këtë rast, Këshilli i Myftinisë Pukë vlerësoi disa hoxhallarë, përfshirë këtu edhe imam Sahit Hoxhën. Kështu, Myftinia Pukë, me Vendim nr. 01 datë: 24.01.2016 e vlerësoi me certifikatë “Mirënjohje” pas vdekjes Imam Sahit Hoxhën me këtë motivacion: “Për kontributin e dhënë për gjatë një dekade si imam në xhaminë e fshatit Kabash Pukë, Pistë etj.”⁽³⁵⁾

REFERENCAT:

1. Në atë kohë Mejtepi i xhamisë së Kodër Hanit ishte një ndër Mejtepet më të njohura te Pukës.
2. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxha arkivuar në Myftininë e Pukës.
3. Zenel Hoxha 1853-1945. Në këtë kohë imam Zenel Hoxha ishte rreth 57 vjeç dhe ishte imam i xhamisë Kodër Hani, po ashtu edhe Myfti. Imam Zenel Hoxha jepte mësim islame edhe në Mejtepin e kësaj xhamie.
4. Duke pasur parasysh faktin që në moshën 16 vjeç, Sahit Hoxha së bashku me Shaban Rexhen ndjekin mësimit islame në Mejtepin e Kabashit.
5. Sipas të dhënave të grumbulluara nga Gëzim Kopani dhe të marra nga djali i Sahitit, Ramadan Hoxha. Ato ishin nga familja Agë të Pukës.
6. Xhamia e Kabashit. Kjo xhami është ndërtuar në kohen e Osmanëve. Fshati Kabash ishte “Bajraku” i Pukës dhe zinte një vend të rëndësishëm. Xhamia Kabash ndodhet në mes të fshatit, tek vendi i quajtur “Lam Lushaj”. Rreth vitit 1914 u rihap Mejtepi i xhamisë Kabash nga imam Sadik Prishtina. Aktualisht xhamia e fshatit Kabash ka një truall, pronë të certifikuar me një sipërfaqe prej 204 m².
7. Libri: “Shaban Rexhë Ahmeti, Njeriu i Punëve të Mira” f. 31, botuar në vitin 2012.
8. Po aty, Libri: “Shaban Rexhë Ahmeti, Njeriu i Punëve të Mira” f. 31.
9. Sipas shkrimit të Gëzim Kopanit, “Historiku i Xhamisë së fshatit Kabash”, viti 2013. (Mejtepi i Kabashit u rihap rreth vitit 1914 nga Imam Sadik Prishtina).
10. Libri: “Shaban Rexhë Ahmeti, Njeriu i Punëve të Mira” f. 32, botuar nga Idriz Ahmetaj në vitin 2012.
11. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxhës arkivuar në Myftininë e Pukës.
12. Libri: “Kabashi Puka që në lashtësi 2” f. 102, botuar në vitin 2008, nga prof. Xhemal Meçi
13. Po aty, Kabashi Puka që në lashtësi 2” f. 102 nga prof. Xhemal Meçi.
14. Sipas të dhënave të familjes së Sahit Hoxhës, Man Tepelia ishte nga një familje e nderuar Shkodrane, i cili vendosi të

mbështesë financiarisht studimet e Sahit Hoxhës. Man Tepelia ka qenë tregtar.

15. Po aty, Kabashi Puka që në lashtësi 2” f. 102, nga prof. Xhemal Meçi.

16. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxha arkivuar në Myftininë e Pukës.

17. Shënim nga Gëzim Kopani, Xhamia e Drishtit është ndërtuar nga Osmanët rreth vitit 1479.

18. Sabri Koçi, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë nga viti 1990-2003.

19. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxha arkivuar në Myftininë e Pukës.

20. Sipas të dhënave të familjes kur Sahiti ishte rreth 23 vjeç, i vdes bashkëshortja e parë, ndërsa bashkëshortja e dytë ka pasur probleme shëndetësore.

21. Nga viti 2016 e në vazhdim Ramadan Hoxha është Anëtar i Këshillit të Myftinisë Pukë.

22. Libri: “Kabashi Puka që në lashtësi 2” f. 102, botuar në vitin 2008, nga prof. Xhemal Meçi. Po ashtu edhe në shkrimin: “Të dhëna Historike të Xhamisë Micoj”, shkruan nga Gezim Kopani, viti 2011. Xhamia Micoj është ndërtuar rreth vitit 1835.

23. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxha arkivuar në Myftininë e Pukës, si dhe në librin “Kabashi Puka që në lashtësi 2”, f. 102, botuar në vitin 2008, nga prof. Xhemal Meçi.

24. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxha arkivuar në Myftininë e Pukës.

25. Libri: “Kabashi Puka që në lashtësi 2”, f. 102, botuar në vitin 2008, nga prof. Xhemal Meçi.

26. Elez Hoxha, Myfti i Pukës, qytetar nderi i Bashkisë Pukë.

27. Bashkëshortja e tij Misirja ishte e bija e Halil Muses.

28. Ka pas të martuar vajzën Naxhijen tek shtëpia e Ahmet Isen Kopani, pra për djalin, Xhemal Kopanin.

29. Familje besimtare ku më vone, djali i tij Qazim Kopani, bëhet Myezin i xhamisë Pukë.

30. Jah Met Kroba, ka qenë Myezin i Xhamisë së fshatit Kabash.

31. Duke qenë se, Zyber Lluka kishte shtëpinë afër xhamisë Kabash, ai kryente shërbime të ndryshme, deri ndihmës Myezin i kësaj xhamie.

32. Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare.

33. Nëna e Sahit Hoxhës ishte kusheri me nënen e Ali Bytyçit.

34. Sipas dorëshkrimit të djalit të tij, Ramadan Hoxha arkivuar në Myftininë e Pukës.

35. Sipas arkivit të Myftinisë Pukë viti 2016. Kur'ani,



Naim Driaj
Imam, xhamia Parrucë

SI T'I KALOJMË PUSHIMET VERORE?

e ikindisë.² “Salatul Asr” Ëkindia është mesi i namazeve. Allahu i Lartësuar thotë: “Falen i rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin...”³ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Ai i cili nuk e falë namazin e ikindisë ai e ka shkatërruar familjen dhe pasurinë e tij”.⁴ Ibn Kethiri ka thënë: “El-Asr” është koha kur ndodhin lëvizjet e njerëzve, si e mira ashtu edhe e keqja. Disa prej dijetareve janë të mendimit se Zoti (xh.sh) është betuar në kohën e Islamit duke u’a bërë me dije muslimanëve se sa kohë e keqe ka qenë koha përpara islamit.⁵

Nëse dikush prej krijesave të Allahut duhet të kujdeset më së shumti për kohën e tij, ai është muslimani, sepse për kohën do të jepet llogari. Ibnul Kajimi ka thënë: “Humbja e kohës është më e madhe se vdekja, sepse humbja e kohës e largon njeriun nga Allahu i Lartësuar dhe nga bota tjetër, ndërsa vdekja të largon vetëm nga kjo botë”.

Allahu (xh.sh) thotë: “Me të vërtetë, njeriu është në humbje”.⁶ Vërtetë njeriu është në humbje. Nëse njeriu vdes duke mos qenë besimtar, duke mos i kryer detyrimet që ka caktuar Allahu për njerëzit, pa dyshim se ai është në humbje të sigurt. Atij nuk do t’i bëjë dobi, as pasuria, as familja, as pozita e tij shoqërore, përveç atij që ka besim të drejtë dhe vepra të pranuar. Pastaj Allahu na njofton për ata që janë

të shpëtuar. Me përjashtim të atyre që besuan...⁷ Ata që kanë dituri, dhe e njohin të vërtetën janë ata që besojnë, dhe e dinë se Allahu ekziston në të vërtetë, premtimi i Tij është i vërtetë dhe Pejgamberi i Tij është i vërtetë, takimi me Atë është i vërtetë, melekët janë të vërtetë, pejgamberët janë të vërtetë, xheneti është i vërtetë si dhe xhehenemi është i vërtetë, dhe pastaj vepron me besimin e tij.

Që porosisin njëri-tjetrit t’i përmbahen të vërtetës... Pasi ta kuptojë të vërtetën dhe të punojë me të, besimtarit i duhet që t’i thërrasë edhe të tjerët në të, dhe ta kryejë detyrimin fetar, sepse si umet jemi dalluar e të privilegjuar që thërrasim dhe urdhërojmë në të mirë dhe ndalojmë nga e keqja, ashtu siç thotë Allahu (xh.sh) në Kuran:

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun”.⁸

Dhe që këshilluan njëri-tjetrit të jenë të durueshëm. Këshilla e fundit është që të jemi të durueshëm, dhe t’i porosisim të tjerët të jenë të durueshëm, sepse siç dihet mbasi t’i urdhërojmë të tjerët në bamirësi, dhe t’i ndalojmë nga veprat e këqija hasim në kundërshtime nga pala tjetër, e kjo porosi Kuranore na mëson se si të veprojmë në këto situata.

Është e çuditshme se të gjithë adhurimet dhe ritet islame, janë të

2. Shiko: “Tefsir Ibn Kethir”.

3. Kur’ani, El-Bekare: 238.

4. Transmetuar nga Muslimi

5. Shiko: “Tefsir el- Kurtubi”.

6. Kur’ani, El-Asr: 2.

7. Kur’ani, El-Asr: 3.

8. Kur’ani, Ali Imran: 110.

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

*“Dy begative
shumica e njerëzve
nuk ua dinë vlerën.
Atë janë:
shëndeti dhe koha e lirë.”*

lidhura ngushtë me kohën. Prandaj duhet ta shfrytëzojmë kohën në mënyrën me të mirë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Dy begative shumica e njerëzve nuk u’a dinë vlerën. Atë janë: shëndeti dhe koha e lirë.” Abdurrahman ibn Xheuzi në librin e tij “Sajdul Hatir” në kapitullin 164 thotë: “Të shoqëruarit me të papunët (me ata njerëz që e shpërdorojnë kohën e lirë) është fatkeqësi”. Hasen El-Basriu thotë: “Në çdo ditë që lind dielli, një zë thërret: O bir i Ademit! Unë jam një ditë e re dhe do të dëshmoj për veprat e tua”.

Nuk është e rastësishme që namazi është i lidhur me kohë të caktuara, ndërkohë që shumë mirë mund të ishte i lidhur me vaktet e ngrënies. Kur e pyetën Profetin (a.s): “Cila është vepra më e dashur tek Zoti?” Ai u përgjigj: namazi në kohën e vet”. “...namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar”.⁹ Kurse për agjërimin thuhet: “Agjërimi zgjat disa ditë...”.¹⁰ Sikur Allahu (xh.sh) na thotë: Shfrytëzojini këto ditë pasi është një kohë e shkurtër dhe përfundon shpejtë. Lidhur me ritet e Haxhit, Zoti (xh.sh) thotë: “Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar”.¹¹ Të gjitha ritet e Haxhit janë të lidhur ngushtë me një kohë të caktuar.

DISA KËSHILLA SE SI DUHET T’I KALOJMË PUSHIMET VERORE

Transmetohet nga Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari i Allahut, ka thënë: “Zjarri i xhehenemit iu ankua Allahut duke i thënë: “O Zot, po zihem me veten”. Atëherë Allahu i lejoi që ta lirojë veten dy herë në vit, njëherë në verë e

9. Kur’ani, En-Nisa: 103.

10. Kur’ani, El-Bekare: 184.

11. Kur’ani, El-Bekare: 197.

tjetrin në dimër. Prandaj nxehtësinë më të madhe që e ndjeni në verë është shfryrje (frymënxjerrje) e zjarrit të xhehenemit, kurse të ftohtin e madh që e ndjeni në dimër është nga shfryrja (frymënxjerrja) e të ftohtit të xhehenemit”.¹²

Stina e verës për ne besimtarët shërben si provë dhe si sprovë. Si Provë për të gjithë ata, që deri dje nuk kanë qenë ashtu siç duhet korrekt me faljen, adhurimin, prezantimin në mësim apo ligjëratë, që janë arsyetuar se s’kemi kohë, jemi të zënë etj... etj...

I këshilloj të gjithë muslimanët që t’i shfrytëzojnë pushimet verore në ato gjëra që e kënaqin Allahun (xh.sh), sikurse janë:

- Mësimi përmendësh i disa sureve të Kur’anit Fisnik dhe shtimi i leximit të tij. Abdullah ibn Mesudi (r.a) ka thënë: “Neve na vinte rëndë të mësojmë fjalët e Kur’anit, kurse e kishim të lehtë veprimin sipas tij, kurse pas nesh do ta kenë të lehtë mësimin përmendsh të Kur’anit mirëpo do ta kenë të vështirë veprimin sipas tij”.¹³

Allahu (xh.sh) thotë: “Dhe i Dërguari do të thotë: “O Zoti im! Vërtet që populli im e braktisi këtë Kuran.”¹⁴ Imam ibn Xheuzij (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Gjeneratat e para të muslimanëve i angazhonin fëmijët e tyre me mësim përmendsh të Kuranit dhe me dëgjim të haditheve sapo fillonin të rriteshin. Kështu, atyre u zinte vend besimi në zemër qysh në vegjëli.”¹⁵

- Frekuentimi i bibliotekave dhe leximi i librave të ndryshëm.

- Prania në ligjëratë dhe në tribuna të dobishme shkencore.

- Vizita e prindërve dhe farefisit.

- Vizita e vendeve islame dhe vendeve historike.

- Pjesmarrja në kurse për mësim të gjuhëve të huaja, mësim të ndonjë zanati etj... etj...

E kanë pyetur imam Ahmedin (r.a) O imam! deri kur do të punojmë? a kemi pushim ndonjë herë? Ai është përgjigjur: “Pushim kemi atëherë kur ta vendosim këmbën në xhenet”.


Ë lutemi Allahut të Lartësuar që këto pushime të na shërbejnë për tu afruar më shumë me Zotin (xh.sh).

12. Transmetuar nga Buhariu në Sahihun e tij, nr. 537, 3260, Muslimi, nr. 1400, 1401, 1402.

13. Shiko: “Tefsir el-Kurtubi”, 1/39-40.

14. Kur’ani, El-Furkan: 30.

15. Sajd El-Hatir, 491.



"I kam hyrë studimit

te Kur'anit pa ndonjë

mendim paraprak

dhe me objektivizëm,

në kërkim të shkallës

së përputhshmërisë se

tekstit kur'anor

me të dhënat

e shkencës moderne.

Arrita në konkluzionin

se nuk ka

asnjë thënie

të kritikueshme

nga pikëpamja

shkencore

bashkëkohore..."

Maurice Bucaille.



Durim Kasemi
Imam, xhamia Parrucë

Pothuajse çdo ditë, dëgjojmë lajme, lexojmë shkrime, e shikojmë emisione televizive në të cilat sulmohet, denigrohet, baltoset e përçudnohet Islami dhe kjo na dhemb të gjithëve, e na bën të ndihemi keq. Madje shpeshherë, tek disa besimdobët dhe të paditur rreth fesë së tyre, edhe mund të ngjallë dyshime rreth vërtetësisë së fesë. Por, nëse i hedhim një vështrim analizues dhe krahasues historisë islame, sidomos fillimeve të saj dhe, krahasojmë të shkuarën me të sotmen në aspektin e mënyrave dhe metodave me të cilat luftohet feja islame dhe myslimanët, do të vërejmë se nuk ka ndryshuar asgjë nga esenca por, vetëm fasada përgjithësisht.

Po të shfletojmë Kur'anin dhe të lexojmë historitë e profetëve me popujt e tyre, do të kuptojmë menjëherë se kjo nuk është diçka e re dhe e veçantë për muslimanët e sotëm, por është realitet me të cilin janë përballur të gjithë pasuesit e profetëve të Allahut në çdo kohë.

Kështu që po të lexojmë historinë e profetit të Allahut, Lut (a.s) dhe përpjekjet e tij të pandalshme për të larguar njerëzit nga veset shkatërruese të një shoqërie dhe devijimet morale, do të hasim në këto ajete. Në suren

ARMIQËSIA NDAJ ISLAMIT, DJE DHE SOT

El-A'araf, ajeti 80- 82, Allahu thotë: "Përkujto kur Luti i tha popullit të vet: "A punoni të shëmtuarën, që asnjë nga popujt e botës nuk e bëri para jush". Vërtet, ju të shtyrë nga epshet u afroheni burrave duke i lënë gratë. Po ju jeni popull i shfrenuar". Përgjigjja e popullit të tij nuk ishte tjetër vetëm se të thonë: "Dëboni ata (Lutin me besimtarë) nga vendbanimi juaj, ata janë njerëz që ruhen shumë (e i largohen të shëmtuarës)".

Edhe sot dëgjojmë thirrje të ngjashme për dëbimin e muslimanëve nga vendi, për dëbimin tonë nga ky vend, edhe pse jemi shqiptarë, kemi edhe ne pjesë nga ky vend, siç kanë edhe ata, por përse ndodhë kjo? Sepse atyre iu pengon Islami, iu pengon prezenca e xhamive kudo, i pengon thirrja e ezanit, i pengon shamia e nënave dhe motrave tona, i pengon sinqeriteti dhe ndershmëria e muslimanëve në punë dhe në të mirë të vendit qysh se ka shkelur Islami në këto troje e deri më sot.

Kjo ka qenë sjellje e tyre gjithmonë. Allahu në suren Ez-Zumer, ajeti 45, thotë: "Kur përmendet vetëm All-llahu, zemrat e atyre që nuk besojnë botën tjetër, neveriten, e kur përmenden, përveç Atij, të tjerët, ata gëzohen". Ky takam njerëzish mbron çdo gjë, vetëm atë që ka të bëjë me Allahun, Krijuesin e tij dhe të gjithësisë nuk e mbron por e sulmon! Allahu i Madhëruar në Kur'an, na ka treguar një fakt shumë të rëndësishëm dhe që qartëson shumë gjëra dhe ju jep përgjigje shumë pyetjeve që mund të sillen në mendjen tonë në lidhje me armiqësinë që kanë mosbesimtarët ndaj besimtarëve. Në suren El-Bekare, ajeti 218, Allahu thotë: "Ata do t'u luftojnë juve vazhdimisht për t'ju zbrapsur, nëse munden, nga

feja juaj".

Në këtë kohë, ku pesimizmi ka zënë vend në zemrat e shumëkujt, njohja e këtij aspekti shumë të rëndësishëm të historisë së Islamit dhe analizimi i tij, na ndihmon për të qenë të qetë, e për të vazhduar përpara, pa u ndikuar nga situatat kalimtare, me të cilat përballet Islami.

Mosbesimtarët e akuzonin Pejgamberin (a.s) se ishte njeri i humbur, i devijuar nga rruga e drejtë. Ebu Lehebi e ndiqte Pejgamberin (a.s) kudo që shkonte për të thirrur njerëzit në Islam dhe bërtiste duke thënë: "O njerëz: ky ka devijuar nga rruga e drejtë, prandaj kini kujdes se mos ju devijon edhe juve". E akuzonin se ishte magjistar, e akuzonin se ishte gënjeshtar e se ishte i çmendur. Për këtë Allahu thotë në suren El-Hixhr, ajeti 6: "Dhe ata thanë: "O ti që t'u shpall përkujtimi (Kur'ani), me të vërtetë ti je çmendur!". Në suren Junus, ajeti 2, Allahu thotë: "E ata që nuk besuan thanë: "S'ka dyshim, kjo është një magji e vërtetë!".

Po të vërejmë, sot përsëriten po të njëjtat akuza, me të njëjtën përmbajtje. Sot, akuzohen muslimanët se janë të çmendur, se nuk përdorin mendjen, se janë njerëz që jetojnë akoma me mendësitë mesjetare dhe primitive etj.

Në kohën e Pejgamberit (a.s) jobesimtarët mundoheshin të hidhnin dyshime rreth vërtetësisë së fesë duke thënë se këto janë përralla të marra nga të parët, janë fjalë të kopjuara nga librat e feve të tjera etj.

Edhe sot hidhen të njëjtat dyshime duke thënë se Kur'ani nuk është gjë tjetër vetëm se libër i vjedhur nga Bibla,

1. Shih: Musned Ahmed, 3/492, nr. 15590. Siretu Ibn Hisham, 2/32.

NË NJË STUDIM, NDËR SHUMË TË TILLË E NGA SHUMË VENDE, QENDRA KËRKIMORE "PEW", ME SELI NË AMERIKË NË NJË STUDIM TË SAJIN TË PUBLIKUAR KOHËT E FUNDIT KA POHUAR SE: ISLAMI ËSHTË FEJA ME RRRITJEN MË TË SHPEJTË NË BOTË NDËR RELIGJIONET, DHE SE NDËRMJET VITEVE 2010-2050, NUMRI I MSULIMANËVE DO TË RRRITET ME 50 % DHE SE NË VITIN 2070, DO JETË MË I MADH SE I GJITHË PASUESVE TË RELIGJIONEVE TË TJERA.

se Islami është fe e arabëve, se Kur'ani është vepër njerëzore etj.

Sot, rreth Islamit përhapen lajme të rreme, siç janë terrorizmi, dhuna ndaj femrës, nxitja e urrejtjes ndërfaqetare dhe ndëretnike dhe që në realitet nuk kanë të bëjnë fare me Islamin, por janë të thëna që përhapen rrejshëm.

Ajo çfarë na intereson neve dhe duhet ta ngulisim fort në mendjet dhe zemrat tona është se, pas të gjitha këtyre përpjekjeve të kahershme dhe të sotme, nuk është ndalur hovi i Islamit, as në të shkuarën siç edhe ka treguar historia, e as nuk po e ndalin sot. Në një studim, ndër shumë të tillë e nga shumë vende, qendra kërkimore "PEW", me seli në Amerikë në një studim të saj in të publikuar kohët e fundit ka pohuar se: "Islami është feja me rritjen më të shpejtë në botë ndër religjionet, dhe se ndërmjet viteve 2010-2050, numri i msulimanëve do të rritet me 50 % dhe se në vitin 2070, do jetë më i madh se i gjithë pasuesve të religjioneve të tjera".²

Për këtë, Allahu na ka thënë në suren Es-Saf, ajeti 8: "Ata duan ta shuajnë

2. Për më tepër të shikohet webfaqja: http://www.huffpostarabi.com/2017/03/02/story_n_15089538.html

dritën e All-llahut me gojë të tyre, po All-llahu e plotëson (e përhap) dritën e Vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët".

Pas kësaj që thamë dikush me të drejtë mund të pyesë: Çfarë duhet të bëjmë ne, në këtë situatë? Cilat janë detyrimet tona si muslimanë në këto rrethana, në të cilat ndodhemi? Cila është përgjigja më e mirë që mund t'i jepet këtyre njerëzve?

Rruga më e mirë që duhet ndjekur në situata të tilla dhe në çdo gjë tjetër është ajo e Pejgamberit (a.s) si dhe orientimi nga mësimet e tij në përgjithësi.

Pejgamberi (a.s), vështirësitë, problemet dhe armiqësitë me të cilat është përballur i ka sfiduar me durim e përmbajtje ndaj urdhrave të Allahut. Me largim nga ndalesat e përkushtim më tepër ndaj fesë së Allahut, sepse kjo ka qenë edhe rruga e Pejgamberëve para tij. Allahu në suren Ali Imran, në ajetin 186, thotë: "Ju patjetër do të provoheni si në pasurinë tuaj, si në vetën tuaj, madje do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është libri para jush, e edhe prej idhujtarëve, po në qoftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare."

Kurse në ajetin 120, të po kësaj sureje, Allahu thotë: "E nëse duroni dhe tregoheni të devotshëm, nuk do ju bëjnë dëm intrigat e tyre (josbesimtarëve)".

Në këto ajete Allahu na jep dy udhëzime se si të triumfojmë mbi të gjitha sfidat, armiqësitë, intrigat dhe vështirësitë që dalin në rrugën e çuarjes së kësaj feje përpara dhe ato janë: Durimi dhe devotshmëria, që do të thotë kryerje e urdhërësive dhe largim nga ndalesat.

Pejgamberi (a.s), në raste të tilla, ishte gjithmonë optimist për ndihmën dhe suksesin e Allahut dhe nuk ngutej për të parë rezultatet. Një ditë në Mekke, në kohën kur muslimanët ishin pak dhe përndiqeshin e torturoheshin nga jobesimtarët, vjen tek i Dërguari i Allahut (a.s), sahabiu i quajtur Khabbab Ibnul-Eret dhe i thotë: O i dërguari i Allahut, a nuk po i lutesh Allahut që të zbresë mbi ne ndihmën e Tij!? Pejgamberi (a.s) i përgjigjet: "Besimtarët që ishin para jush torturoheshin duke u groposur në tokë dhe duke u sharruar në dysh, e ju hiqej mishi me krehra hekuri, por megjithëkëtë nuk hiqnin dorë nga feja e tyre. Pasha Allahun, o Khabbab kjo fe do të triumfojë, por ju nguteni!"³

3. Transmetuar nga Buhariu, nr.36121.



"Kontributi i shqiptarëve

MUSLIMANË ËSHTË

i palloqaritshëm.

Madje, atje ku kemi

shqiptarë muslimanë,

ndjenja e atdhedashurisë

është maksimale.

Ishin shqiptarët

muslimanë, ata që

e bartën barrën

më të madhe të çështjes

sonë kombëtare.

Muslimanët shqiptarë

e kanë në gene

atdhedashurinë.

Kështu na mëson

feja jonë islame!"

Studiuesi islam, Ajni Sinani

Paraditën e së enjtes, më 13 korrik 2017, Myftinia Shkodër zhvilloi “Mbledhjen e Raporteve të Ramazanit”, për vitin 1438 h.

Në fjalën e tij, teologu Lavdrim Hamja, theksoi se formati i këtij takimi të përvitshëm është një risi në raport me analizimin e një Muaji të tërë të mbushur me aktivitete, adhurime dhe lutje kolektive, bamirësi dhe dëshmim i frymës së harmonisë komunitare në Shkodër.

Referuan dhe lexuan analizat dhe relacionet e tyre të përmbledhura, teologët Lavdrim Hamja, Arben Halluni, Idmir Plaku, Naim Drijaj dhe Adem Pizga.

Në relacionet e tyre, imamët e nderuar prezantuan larminë e aktiviteteve, si dhe dhanë sugjerimet dhe idetë e tyre të dobishme në përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit fetar në Ramazan.

Imamët vlerësuan praninë e madhe të rinisë për gjatë krejt Ramazanit, sidomos në faljen namazit të teravisë, si dhe adhurimeve të ndryshme gjatë këtij muaji.

Në fjalën e tij të rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari,

U ZHVILLUA “MBLEDHJA E RAPORTEVE TË RAMAZANIT”



shprehu mirënjohjen e tij për teologët e Shkodrës, që dëshmuar një angazhim të madh gjatë këtij muaji.

Myftiu tha se, me kontributet e tyre, teologët e Shkodrës janë një shembull pozitiv për çdo myftini, sidomos me shkrimet dhe ligjëratat e tyre, të pasqyruara më së miri edhe në gazetën “Udha Islame”.

Njëkohësisht, lajmëroi krijimin e një komisioni teologjik, nën drejtimin e imamet Idmir Plaku, në përbërje të cilit do jenë edhe teologët: Arben Halluni, Lavdrim Hamja, Durim Kasemi dhe Adem Pizga, që do të mbledhet pesë muaj para Ramazanit të ardhshëm, për të diskutuar larminë e aktiviteteve të Ramazanit 1439.

MYFTINIA SHKODËR DËNON AKTIN BARBAR TË MBYLLJES SË XHAMISË SË SHENJTË NË AKSA

Myftinia Shkodër dënon me zemërim të thellë krimin e mbylljes së Xhamisë së Shenjtë të Aksasë në Palestinën martire, një akt barbar dhe primitiv, që nuk ka lidhje me asnjë qytetërim të bazuar në vlerat e besimit!

Ndalimi i ezanit, moslejimi i faljes së namazit të xhumasë dhe lëndimi i shenjtërive të tjetrit është një akt terrorist i papranueshëm nga besimtarët, sikurse dëshmon vdekjen e zemrës dhe arsyes së shëndoshë që ndërton ura komunikimi në mesin e njerëzve!

Islami dënon aktet e dhunës ndaj objekteve të kultit, sikurse konsideron si kulmin e zullumit atë që po dëshmohet sot, në Palestinën martire!

Myftinia Shkodër fton të gjithë besimtarët të luten me zemër



kundër terrorit dhe zullumit, si dhe të dënojnë krimet barbare të makinerive të së keqes kundër popullit palestinez dhe mbarë njerëzimit!

Myftinia Shkodër fton të gjithë besimtarët që ditën e xhuma, më 21

korrik 2017, në të gjitha xhamitë e Shkodrës të zhvillohen lutje masive kundër terrorizmit dhe islamofobisë, dhunimit të shenjtërive të muslimanëve dhe shkeljes së të drejtave të tyre!

Shkodër, më 15 korrik 2017

TAKIM PUNE ME IMAMËT E QYTETIT



Paraditën e së mërkurës, më 19 korrik 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e qytetit, me të cilët diskutoi larminë e aktivitetit fetar, social e kulturor në prag të Kurban Bajramit.

U diskutua edhe programin 10 javor i hytbeve të xhumasë në xhaminë e fshatit Luarëz, Velipojë, në shërbim të vizitorëve të shumtë që vijnë të falen në këtë xhami.

Njëkohësisht u paraqit edhe një program me aktivitete që i paraprijnë Kurban Bajramit, trajnimit të haxhilerëve të këtij viti, ceremonisë së përcjelljes së tyre etj.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe

Imam Didmar Faja, imam i Qendrës së Bashkuar Islame të Arizonës, i cili ndodhet për një vizitë të shkurtër në Shkodër.

Imami i nderuar falënderoi të pranishmit për angazhimet e tyre në shërbim të Thirrjes Islame, si dhe bëri një prezantim të aktivitetit të tij në rritje në ShBA.

Më herët, Myftiu shprehu mirënjohjen e tij për këtë prani të thirrësit islam shqiptar, Imam Didmar Faja, në mesin e teologëve të Shkodrës dhe i uroi atij mbarësi në angazhimet e suksesshme në Amerikë dhe Meksikë, ku me qindra qytetarë të këtyre vendeve janë bërë muslimanë para duarve të tij.

PROGRAMI 10 JAVOR I HYTBEVE NË XHAMINË E LUARZIT, VELIPOJË

Në kuadër të sezonit veror 2017, ku shumë pushues nga Kosova dhe emigracioni, vijnë për të kaluar pushimet e tyre në vendin tonë, me propozim dhe kërkesë të vazhdueshme të imamet të nderuar të xhamisë së fshatit Luarëz, z. Hajrullah Jakupi, për qarkullimin e disa imamëve për ligjëratën e xhumasë në këtë xhami për shkak të pjesëmarrjes së madhe, Myftinia Shkodër, sheh të arsyeshme zhvillimin e këtij programi dhjetë javor, me qëllim pasurimin e aktivitetit të saj në xhaminë e fshatit Luarëz dhe paraqitjen e temave të larmishme nga hatibët më të afirmuar të qytetit.

Duke nisur nga kjo e xhuma, më 21 korrik 2017, ligjëruesit kryesorë të Shkodrës, do të prezantojnë me hytbet e tyre në ceremonitë e ditës së xhuma në këtë xhami.

Në takimin e ditës së sotme, më 19 korrik 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, diskutoi me teologët e nderuar programin e hartuar me këtë rast, si vijon:

1. 21 korrik 2017, teologu Ervil Kuçi, tema: “Pastërtia në Islam”.
2. 28 korrik 2017, teologu Adem Pizga, tema: “Familja dhe vlerat e saj në Islam”.
3. 4 gusht 2017, H. Fejzi Zaganjori, tema: “Fjala e mirë, paqtim”.
4. 11 gusht 2017, teologu Hysejn Muça, tema: “Lutja dhe mirësitë e saj në jetë”.
5. 18 gusht 2017, teologu Adrian Uraj, tema: “Mirësjellja, veçori e muslimanit”.
6. 25 gusht 2017, teologu Durim Kasemi, tema: “Kur’ani, udhërrëfim për njerëzinë”.
7. 1 shtator 2017, teologu Idmir Plaku, tema: “Mësime nga leximi i sures {Jusuf}”.
8. 8 shtator 2017, teologu Lavdrim Hamja, tema: “Respekti ndaj prindit”.
9. 15 shtator 2017, teologu Naim Drijaj, tema: “Muslimani dhe mbrojtja e mjedisit”.
10. 22 shtator 2017, teologu Arben Halluni, tema: “Dhikri, ushqim për shpirtin e njeriut”.



All-llahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

**"Kush është
më fjalëmirë
se sa ai,
që thërret
për tek
All-llahu,
punon vepra
të mira
dhe thotë:
Unë jam prej
myslimanëve!"**

(Kur'ani, Fussilet: 33)

**"NË QOFTË SE FEJA
NUK ËSHTË SJELLJE E BUKUR,
FYTYRË E QESHUR, SHPIRT TOLERANT,
FOINJËSI E MIRË DHE JETË TËRHEQËSE,
ÇFARË ËSHTË AJO!?**

**PËRPARA KËSAJ, NË QOFTË SE FEJA
NUK ËSHTË NEVOJË PËR ALLAHUN,
PËRGJËRIM I PËRHERSHËM
PËRPARA PRANISË SË TIJ,
LUTJE PËR MËSHIRËN E TIJ TË MADHE
DHE ASPIRATË QË MIRËSIA E TIJ
TË PËRFSHIJË TËRË NJERËZIT
DHE BOTËN MBARË,
ÇFARË ËSHTË AJO"?**

Shejkh MUHAMED EL-GAZALI

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org